# PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË "ARSIMIT FILLOR"

ASCAP

## Program orientues

Koordinator:
Aurela Zisi
Edlira Sina

2025-2026

# TABELA E PËRMBAJTJES


**TABELA E PËRMBAJTJES....................................................1**

**HYRJE....................................................2**

**SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT....................................................3**

**PËRMBAJTJA E PROGRAMIT....................................................5**

**Orientime dhe udhëzime për planifikimin dhe zhvillimin e orës së hapur të mësimit - Kategoritë "Mësues i kualifikuar" dhe "Mësues specialist"....................................................24**

**Orientime rreth planifikimit të orës së hapur të mësimit....................................................26**

**Orientime dhe udhëzime për projektin kurrikular–Kategoritë "Mësues specialist" dhe "Mësues mjeshtër"....................................................45**

# HYRJE

Profesioni i mësuesit kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta pune dhe etike. Mësuesi i arsimit fillor vepron me ndershmëri dhe integritet të lartë profesional, zotëron përmbajtjen e lëndëve nga klasa e parë në të pestën, përditëson dijet dhe aftësitë profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve të vazhdueshme, krijon dhe pasuron sistematikisht portofolin e zhvillimit profesional, përfshihet në procesin e vetëvlerësimit, dokumenton vlerësimet që i bëhen, krijon marrëdhënie korrekte me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve dhe të shoqërisë.

Programi i zhvillimit profesional, për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të arsimit fillor, është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- për kandidatët e kategorisë "**Mësues i kualifikuar**", procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet:
  - **dosjes së zhvillimit profesional**;
  - vlerësimit të **orës së hapur të mësimit**;
  - vlerësimit me **test të informatizuar**, i cili administrohet dhe monitorohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).
- për kandidatët e kategorisë "**Mësues specialist**", procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet:
  - **dosjes së zhvillimit profesional**;
  - vlerësimit të **orës së hapur të mësimit**;
  - vlerësimit të **projektit kurrikular**;
- për kandidatët e kategorisë "**Mësues mjeshtër**", procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet:
  - **dosjes së zhvillimit profesional**;
  - vlerësimit të **projektit kurrikular**.

# SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të arsimit fillor është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MAS-it Nr.17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë". Ai synon t'u vijë në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të arsimit fillor për zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit;
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit e arsimit fillor që do të hyjnë në këtë proces.

Synimet e programit të zhvillimit profesional të mësuesve të arsimit fillor janë:

- *të ndihmojë* çdo mësues që do të kualifikohet për kriteret që duhet të plotësojë dhe procedurat që duhet të ndjekë për të marrë kategorinë e synuar të kualifikimit;
- *të japë* orientime dhe udhëzime që kërkohen nga MAS-it për të ndihmuar të gjithë mësuesit e arsimit fillor të krijojnë portofolin e zhvillimit profesional dhe të përgatiten në mënyrë cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat e kualifikimit për secilën kategori;
- *të lehtësojë* punën e DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar seancat e informimit dhe të trajnimit në lidhje me ndryshimin e procedurave për marrjen e kategorive të kualifikimit "Mësues i kualifikuar", "Mësues specialist" dhe "Mësues mjeshtër".

***Programi ka për qëllim që mësuesi i arsimit fillor që kandidon për marrjen e shkallëve të kualifikimit:***

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënit, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;

- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet global që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin, çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zbatojë rregullat drejtshkrimore të gjuhës shqipe;
- të zhvillojë aftësitë e përdorimit të TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar;
- të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

# PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të arsimit fillor është i organizuar në tri pjesë:

- *Pjesa e parë*: **Orientime dhe udhëzime për testimin e informatizuar**. Në këtë rubrikë përfshihen, kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve me alternativa sipas rubrikave të këtij testimi.
- *Pjesa e dytë*: **Orientime dhe udhëzime për planifikimin dhe zhvillimin e aktivitetit të hapur ditor**. Në këtë pjesë të programit jepen udhëzime rreth formatit të orës së mësimit, kërkesat që duhen mbajtur parasysh nga çdo kandidat, si dhe kriteret e vlerësimit të orës së mësimit, të cilave do t'u referohen drejtuesi i shkollës, koordinatori i cilësisë së shkollës/kryetari i ekipit lëndor, drejtuesi i rrjetit profesional dhe përfaqësuesi i ZVAP-it për të bërë vlerësimin.
- *Pjesa e tretë*: **Orientime dhe udhëzime për planifikimin dhe zhvillimin e projektit kurrikular**. Në këtë pjesë të programit jepen udhëzime rreth rubrikave të projektit kurrikular që do të zgjedhin kandidatët për ta zhvilluar nxënësit e klasës, si dhe kriteret e vlerësimit të tij, të cilave do t'u referohen drejtuesi i shkollës, koordinatori i cilësisë/kryetari i ekipit lëndor, drejtuesi i rrjetit profesional dhe përfaqësuesi i ZVAP-it.

Testi i informatizuar për mësuesit që synojnë të marrin kategorinë e kualifikimit “Mësues i kualifikuar” përbëhet nga dy pjesë:

a) *Pjesa e parë* përmban pyetje, ushtrime dhe kërkesa që lidhen me zbatimin e programeve mësimore, me pedagogjinë dhe mësimdhënien në arsimin fillor, me përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie me mjedisin e të nxënit, me vlerësimin e nxënësve, me etikën, komunikimin dhe drejtshkrimin e gjuhës shqipe.
b) *Pjesa e dytë* përfshin pyetje, kërkesa dhe ushtrime që lidhen me zbatimin e përmbajtjes shkencore të lëndëve të arsimit fillor.

## Fushat e testimit të mësuesve – Kategoria "Mësues i kualifikuar"

Fushat në të cilat do të testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve të kategorisë "Mësues i kualifikuar" janë:

- kurrikula e arsimit fillor, nga klasa e parë në të pestën;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut gjatë mësimdhënies;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndëve në arsimin fillor, nga klasa e parë në të pestën.

| FUSHAT | KOMPETENCAT |
|---|---|
| Kurrikula e arsimit fillor | Zbatimi në mënyrë efektive i kërkesave të kurrikulës me kompetenca, nga klasa e parë në klasën e pestë. |
| Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të Tik-ut në mësimdhënien e arsimit fillor | Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin fillor.<br>1. Përdorimi i metodave ndërvepruese dhe i formave të ndryshme të punës me nxënësit e kësaj moshe, realizimi i integrimit ndër lëndor.<br>2. Përdorimi i instrumenteve të ndryshme të vëzhgimit dhe të vlerësimit të nxënësve. |
| Aspekte të etikës dhe të komunikimit | Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit. |
| Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe | Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. |
| Përmbajtja shkencore e lëndëve të arsimit fillor | Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndëve të ciklit fillor. |

Për fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave. Gjithashtu, programi përmban literaturën rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushave/lëndëve të arsimit fillor. Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përgatitet për testimin kombëtar për marrjen e kategorisë "Mësues i kualifikuar".

| FUSHA: KURRIKULA E ARSIMIT FILLOR | |
|---|---|
| **Kompetenca**<br><br>**"Zbatimi në mënyrë efektive i kërkesave të kurrikulës me kompetenca"** | **Literatura e rekomanduar** |
| **Rezultatet e pritshme**<br><br>*Mësuesi i arsimit fillor:*<br><br>• *qëndron* i mirinformuar për të rejat e reformës kurrikulare, pjesë e të cilës është edhe arsimi fillor;<br><br>• *zbaton* kurrikulën me kompetenca, duke respektuar të gjitha kërkesat e saj;<br>• *përdor* me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetit të zbatimit të programeve lëndore dhe të integrimit ndër lëndor;<br>• *përdor* materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;<br>• *harton* objektiva (rezultate të nxëni) për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, | ▪ Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar<br>▪ Kurrikula bërthamë e arsimit fillor<br>▪ Programet lëndore për klasat 1-5<br>▪ Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës me kompetenca në Arsimin Fillor, ASCAP, 2023. |

| | |
|---|---|
| në përputhje me objektivat (shkathtësitë) e programit;<br>• *shpjegon* lidhjen program-tekst-plan mësimor vjetor dhe planet e periudhave;<br>• *planifikon* projekte kurrikulare;<br>• *përzgjedh* mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programeve lëndore;<br>• *harton* teste sipas kritereve të caktuara për të vlerësuar njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e nxënësve në lëndë të ndryshme të arsimit fillor. | |
| **FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIEN E ARSIMIT FILLOR** | |
| **Kompetenca I**<br><br>**"Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin fillor"** | **Literatura e rekomanduar** |
| **Rezultatet e pritshme**<br><br>*Mësuesi i arsimit fillor:*<br><br>• *është* njohës i mirë i aspekteve didaktike dhe pedagogjike të mësimdhënies, i stileve të të nxënit dhe i psikologjisë moshore të nxënësve me të cilët punon;<br>• *shfrytëzon* literaturën bashkëkohore për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit; | ▪ Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar<br>▪ Kurrikula bërthamë e Arsimit fillor<br>▪ Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës me kompetenca në Arsimin Fillor, ASCAP, 2023<br>▪ Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij. |

| | |
|---|---|
| • *analizon* elementet që i bashkojnë dhe i dallojnë llojet e mësimdhënies me njëra-tjetrën;<br>• *menaxhon* situata, sjellje dhe veprime të ndryshme nxënësish;<br>• *zotëron* aftësitë dhe kompetencat profesionale që i duhen mësuesit të ciklit fillor;<br>• *zhvillon* mësimdhënie të diferencuar;<br>• *dallon* vështirësinë në të nxënë nga aftësia e kufizuar;<br>• *harton* plane edukative individuale (PEI);<br>• *krijon* klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;<br>• *planifikon* orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;<br>• *prezanton* materiale didaktike duke përdorur programet më të njohura kompjuterike. | |
| **Kompetenca II**<br><br>**Përdorimi i metodave ndërvepruese dhe i formave të ndryshme të punës me nxënësit e kësaj moshe, realizimi i integrimit ndër lëndor** | **Literaturë e rekomanduar** |
| **Rezultatet e pritshme**<br><br>*Mësuesi i arsimit fillor:*<br><br>• *motivon* nxënësit në forma e mënyra efektive; | ▪ Të nxënit me situata, kompetenca dhe situata e të nxënit, IZHA 2014.<br>▪ Korniza e vlerësimit të nxënësit<br>▪ Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës me kompetenca në Arsimin Fillor, ASCAP, 2023 |

<table>
<tr><td>

- *zbaton* metodat ndërvepruese të mësimdhënies në përshtatje me lëndën, temën e mësimit dhe me moshën e nxënësve;
- *planifikon* veprimtari që nxisin të menduarit kritik e krijues të nxënësve;
- *krijon* klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;
- *planifikon* orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;
- *përdor* metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;
- *përdor* metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen.

</td><td>

- Urdhër për miratimin e "Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit", nr. 84 datë 06.05.2021.
- Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021.
- Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, planifikimin e punës me nxënësit me aftësi të kufizuar, hartimin e Planit edukativ individual (PEI), disiplinimin pozitiv të sjelljes së nxënësve në klasë etj..

</td></tr>
<tr><th>Kompetenca III<br><br>Përdorimi i instrumenteve të ndryshme të vëzhgimit dhe të vlerësimit të nxënësve</th><th>Literaturë e rekomanduar</th></tr>
<tr><td>

**Rezultatet e pritshme**

*Mësuesi i arsimit fillor:*

- *përdor* mënyra e strategji të ndryshme të dokumentimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të nxënësve;
- *vëzhgon* dhe vlerëson me përshkrim ecurinë dhe përparimin e nxënësit, duke përdorur instrumente të ndryshme;

</td><td>

- Korniza e vlerësimit të nxënësit në arsimin parauniversitar
- Nivelet e arritjes së kompetencave të fushave të të nxënit, (arsimi fillor) klasa I-III dhe IV-V, IZHA, mars 2019.
- Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 "Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar".
- Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP, 2019.

</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>

- *dokumenton* detyra e punime të nxënësve që dëshmojnë përparimin dhe interesin e tyre për shkollën dhe komunitetin përreth;
- *punon* me prindërit për përmirësimin e përparimit të nxënësit.

</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT</td></tr>
<tr><td>Kompetenca<br><br>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</td><td>Literatura</td></tr>
<tr><td>

**Rezultatet e pritshme**

*Mësuesi i arsimit fillor:*

- *njeh* rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;
- *sillet* në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.

</td><td>

- Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat, miratuar nga MAS, më 30.11.2013.
- Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin e MAS-it, nr.31, datë 28.01.2020.
- Urdhri i MAS-it, nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

</td></tr>
<tr><td colspan="2">FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE</td></tr>
<tr><td>Kompetenca<br><br>“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”</td><td>Literatura</td></tr>
<tr><td>

**Rezultatet e pritshme**

*Mësuesi i arsimit fillor:*

</td><td>

- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| • *zbaton* rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe, në të folur, në të lexuar dhe në të shkruar;<br>• zbaton rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në çdo veprimtari në institucionin arsimor. | |

| **FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËVE TË ARSIMIT FILLOR** | |
|---|---|
| **Kompetenca**<br><br>**Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndëve të ciklit fillor** | **Literatura e rekomanduar** |
| **Rezultatet e pritshme**<br><br>*Mësuesi i arsimit fillor:*<br><br>• *zotëron* konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë në nivel shkencor dhe didaktik;<br>• *transmeton* konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë dhe rregullat në përshtatje me moshën dhe të nxënit e nxënësve;<br>• *zotëron* njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që fitojnë nxënësit nga klasa 1-5 për çdo program lëndor;<br>• *planifikon* sipas vështirësive tipike që hasin nxënësit gjatë procesit mësimor;<br>• *përshtat* programet lëndore për nxënësit që paraqesin vështirësi në të nxënë ose që janë me aftësi të kufizuar. | ▪ Të gjitha programet lëndore që përmban plani mësimor, klasat 1-5.<br>▪ Tekstet shkollore nga klasa 1-5.<br>▪ Botime të ndryshme në ndihmë të mësuesve dhe nxënësve. |

## Modele pyetjesh me alternativa

Testi i informatizuar përmban vetëm pyetje me alternativa. Pyetjet i përkasin kurrikulës së arsimit fillor, mësimdhënies dhe të nxënit, vlerësimit të nxënëseve, përmbajtjes shkencore të lëndëve të arsimit fillor, etikës, komunikimit dhe drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

### A. Modele pyetjesh për kurrikulën arsimit fillor

**Pyetja 1**

Emërtimi i plotë i dokumentit të Kornizës kurrikulare, pjesë e së cilës është edhe arsimi fillor, është:

A) Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar;
B) Korniza kurrikulare e arsimit bazë;
C) Korniza kurrikulare e arsimit të detyruar;
D) Korniza kurrikulare e arsimit fillor.

**Pyetja 2**

Shprehin kritere të njëjtësuara për vlerësimin e njohurive, të shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësve sipas fushave përkatëse.

A) Nivelet e arritjes.
B) Kompetencat kyç.
C) Shkallët e kurrikulës.
D) Llojet e vlerësimit.

**Pyetja 3**

Njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat janë përcaktuar për çdo:

A) lëndë të arsimit fillor;
B) klasë të arsimit fillor;
C) shkallë kurrikule;
D) Cikël arsimor.

**Pyetja 4**

Çfarë do të thotë të zgjidhësh një situatë problemore?

A) Të plotësosh njohuritë e fituara.
B) Të vlerësosh njohuritë e fituara.
C) Të mbash qëndrim për njohuritë e fituara.
D) Të përdorësh njohuritë e fituara për zgjidhjen e saj.

**Pyetja 5**

Në ______________ përcaktohet se çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit, cilat vlera duhen kultivuar, si duhen aftësuar ata për bashkëjetesë e tolerancë dhe si mund të japin ndihmesë në mënyrë aktive për mirëqenien shoqërore dhe vetjake.

A) mësimdhënie
B) vlerësim
C) kurrikul
D) standard

**B. Modele pyetjesh për aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në arsimin fillor**

**Pyetja 6**

______________ ka të përcaktuar temën, kohëzgjatjen, rezultatet e të nxënit, konceptet kryesore, veprimtaritë kryesore, partnerët, burimet, produktin kryesor dhe kriteret e vlerësimit:

A) Kurrikula me zgjedhje
B) Projekti kurrikular
C) Veprimtaria ekstrakurrikulare
D) Veprimtaria ndërkurrikulare

**Pyetja 7**

Në arsimin fillor, ___________i shërbejnë përshtatjes së nxënësve me një formë më të sistemuar të të nxënit nëpërmjet lojës, punës, mësimit, si dhe aftësimit të tyre për të bërë dallimin mes lojës dhe detyrës:

A) përvojat mësimore;
B) metodat e mësimdhënies;
C) punët praktike;
D) detyrat shkencore.

**Pyetja 8**

I gjithë procesi i të nxënit në fushën e shkencave ka në fokus zhvillimin:

A) e përdorimit të procedurave shkencore;
B) e kërkimit shkencor;
C) e strategjive të eksplorimit;
D) e komunikimit në gjuhën e shkencës.

**Pyetja 9**

_____________ luan një rol të rëndësishëm në shprehjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore të shoqërisë dhe në zhvillimin, afrimin dhe ruajtjen e identitetit kulturor.

A) gjuha
B) historia
C) qytetaria
D) arti.

**Pyetja 10**

_____________ përbën thelbin e të mësuarit të sotëm, bazuar në parimin didaktik "Të mësuarit e nxënësit në shkollë duhet të imitojë të menduarin e shkencëtarit apo të hulumtuesit të ardhshëm".

A) Mësimi zbulues
B) Vrojtimi
C) Ekskursioni
D) Diskutimi

**Pyetja 11**

Mësimdhënia ndërvepruese NUK është:

A) mësimdhënie bashkëkohore;
B) mësimdhënie për të nxënë;
C) mësimdhënie me fëmijën në qendër;
D) pronë e mësuesit.

**Pyetja 12**

Për të zhvilluar më tej aftësitë e nxënësve në njohjen e fakteve historike, interpretimin e tyre kritik dhe analitik mësuesi:

A) zhvillon vizita në muze dhe qendra historike;
B) përqendrohet në informacionin e tekstit;
C) përdor diskutimin gjatë orës mësimore;
D) shpjegon dukuritë dhe proceset historike.

**Pyetja 13**

Mësimdhënia e bazuar në kompetenca është ndërtuar mbi parimet:

A) e teorisë bihevioriste;
B) e teorisë konjitiviste;
C) e teorisë humaniste;
D) e teorisë konstruktiviste.

**Pyetja 14**

Mësimdhënie ku mësuesi planifikon variante të ndryshme për ato që nxënësit kanë nevojë të mësojnë, mënyrat sesi do t'i mësojnë dhe si do t'i shprehin ato që kanë mësuar me qëllim që të plotësohen nevojat e secilit prej tyre quhet:

A) mësimdhënie e diferencuar;
B) mësimdhënie ndërvepruese;
C) mësimdhënie e integruar;
D) mësimdhënie me projekte.

### C. Modele pyetjesh për aspekte të komunikimit dhe etikës

**Pyetja 15**

Përgatitja e punonjësve arsimorë për të punuar në institucione dhe në mjedise gjithëpërfshirëse mbetet një prioritet i sistemit arsimor parauniversitar. Arsimi gjithëpërfshirës i përgjigjet një sistemi arsimor që:

A) nxit veçimin dhe izolimin e nxënësve me aftësi të kufizuar;
B) thekson nevojën për të nxitur më shumë edukimin e djemve;
C) inkurajon arsimimin e nxënësve me nevoja të veçanta përmes shkollave speciale;
D) siguron përfshirjen e të gjithë nxënësve, pavarësisht nga kushtet fizike, intelektuale, shoqërore, gjuhësore ose kushte të tjera të ndryshme.

**Pyetja 16**

Një nga nxënësit është i shqetësuar në klasë. Cila është mënyra më e mirë e komunikimit që mësuesi të qetësojë fëmijën?

A) Rri indiferent ndaj shqetësimit të fëmijës.
B) E përfshin dhe inkurajon më shumë në aktivitete që të ndihet mirë në ambientin e grupit/ klasës.
C) Diskuton me të gjithë nxënësit rreth shqetësimit të tij.
**D)** Zbaton masa disiplinore.

**Pyetja 17**

Sipas Kodit të Etikës:

A) mësuesi ka për detyrë të njohë të gjitha format e mundshme të dhunës (fizike, psikologjike etj.) ndaj nxënësve;
B) mësuesi nuk ka për detyrë të njohë të gjitha format e mundshme të dhunës (fizike, psikologjike etj.) ndaj nxënësve;
C) mësuesi ka për detyrë të njohë disa nga format e mundshme të dhunës (fizike, psikologjike etj.) ndaj nxënësve;
D) mësuesi përpiqet të ofrojë aq sa mundet për nxënësit e tij dhe pranon se kontributi i tyre nuk mjafton në përvetësimin e njohurive.

## D. Modele pyetjesh për aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

**Pyetja 18**

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

A) Komisioni në ZVAP rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor kur fëmija nuk e ka.
B) Komisioni në ZVAP rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjekoligjor kur fëmija nuk e ka.
C) Komisioni në ZVAP rekomandon pajisjen e fëmijës me Raportin Mjekoligjor kur fëmija nuk e ka.
D) Komisioni në ZVAP rekomandon pajisjen e fëmijës me Raportin Mjekoligjor kur fëmija nuk e ka.

**Pyetja 19**

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

A) vendim marrje
B) vendimmarrje
C) vendimarrje
D) vendimmarje

**Pyetja 20**

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

A) fjalor frengjisht- shqip
B) fjalor frëngjisht/ shqip
C) fjalor frëngjisht- shqip
D) fjalor frëngjisht shqip

**Pyetja 21**

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

A) një milion e pesë qind mijë e dyqind e trembëdhjetë.
B) një milion e pesëqindmijë e dyqind e trembëdhjetë.
C) një milion e pesëqind mijë e dyqind e trembëdhjetë.
D) një milion e pesëqind mijë e dy qind e trembëdhjetë

## E. Modele pyetjesh për përmbajtja shkencore të lëndëve në arsimin fillor

**Pyetja 22**

Në fjalinë "Këtu ka BUJTUR disa ditë Gjergj Kastrioti", fjala me shkronja kapitale tregon që:

A) Skënderbeu ka jetuar përgjithmonë.
B) Skënderbeu është strehuar për një periudhë kohe.
C) Skënderbeu ka banuar për një kohë të shkurtër.
D) Skënderbeu ka qenë i ftuar.

**Pyetja 23**

Në fjalinë "Gjumin e kemi bërë copa-copa, duke fluturuar mbi qytete të ndryshme", pjesa e nënvizuar tregon se:

A) kemi fjetur keq;
B) kemi fjetur pak;
C) nuk kemi vënë gjumë në sy;
D) kemi fjetur top.

**Pyetja 24**

Në fjalinë " Po udhëtojmë drejt Adriatikut", kryefjala është:

A) e shprehur qartë;
B) e nënkuptuar;
C) veta e parë, numri njëjës;
D) veta e tretë, numri shumës.

**Pyetja 25**

Në fjalinë "Është ftohtë" fjala *ftohtë* është:

A) kallëzues emëror;
B) kallëzues foljor;
C) rrethanor;
D) kundrinor.

**Pyetja 26**

Konceptet për traditat kombëtare trajtohen në tematikën:

A) Të jemi të përgjegjshëm;
B) Kombi ynë;
C) Rruga;
D) Kultura.

**Pyetja 27**

Në numrat dhjetorë, presja tregon ndarjen:

A) midis klasave;
B) në rende;
C) e pjesës së plotë dhe jo të plotë;
D) e pjesës së plotë nga pjesa dhjetore.

**Pyetja 28**

Kuptimi i shprehjes frazeologjike "fut hundët" është:

A) Ngatërrohem
B) Ndërhyj
C) Përzihem
D) Grindem

**Pyetja 29**

Vija është element i:

A) baletit dhe operës;
B) muzikës dhe letërsisë;
C) pikturës dhe vizatimit;
D) skulpturës dhe qeramikës.

**Pyetja 30**

Një “Qytetar Nderi”,  duhet të jetë një njeri:

A) orator
B) simbol respekti
C) prind i kujdesshëm
D) patriot

**Pyetja 31**

Cila nga pjesët i përket pjesëve softuer të kompjuterit?

A) (RAM) memoria;
B) (CPU) procesor;
C) (HDD) hard disk;
D) Aplikacionet.

**Pyetja 32**

Zgjidhja e ekuacionit  $X : 8 - 4X + 2(2X - 3) = 5$ është:

A) 78;
B) 80;
C) 88;
D) 90.

**Pyetja 33**

Reshjet maten me:

A) pluviometër;
B) sizmograf;
C) hidrometër;
D) barometër.

**Pyetja 34**

Marshimi në natyrë është:

A) veprimtari lëvizore;
B) veprimtari edukuese;
C) veprimtari sportive ndihmëse;
D) veprimtari lëvizore edukuese.

**Pyetja 35**

Kur instrumentisti godet tastin ose telin ashpër tingulli është:

A) i hollë
B) i trashë
C) i fortë
D) i vrazhdë.

**Pyetja 36**

Dritëhija e bën një objekt të duket:

A) më afër
B) më larg
C) me vëllim
D) më i vogël

**Pyetja 37**

Loja me stafeta përfshihet në:

A) Gjimnastikë;
B) lojëra lëvizore;
C) atletikë;
D) lojëra para sportive.

**Pyetja 38**

Sa është perimetri i një katrori me brinjë sa ajo e një trekëndëshi barabrinjës me perimetër 36 cm?

A) 48 cm;
B) 50 cm;
C) 52 cm;
D) 54 cm.

## Orientime dhe udhëzime për planifikimin dhe zhvillimin e orës së hapur të mësimit - Kategoritë "Mësues i kualifikuar" dhe "Mësues specialist"

Sipas Nenit 8 të Udhëzimit të MAS-it Nr.17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë" ora e hapur mësimore, duhet të ketë krijimtari, risi, profesionalizëm, gjithëpërfshirje dhe efektivitet. Mësimdhënia me kompetenca kërkon mësues të aftë për të lehtësuar të nxënit e nxënësve, të përkushtuar ndaj tyre dhe nevojave që kanë, si dhe për t'iu siguruar strategji, mjete dhe burime të përshtatshme për ta bërë të nxënit sa më efektiv.

Në planifikimin dhe zhvillimin e orës së hapur së mësimit, mësuesi duhet të demonstrojë të kuptuarin e qasjes me kompetenca të kurrikulës së arsimit fillor, zotërimin e përmbajtjes shkencore të lëndëve që zhvillohen në arsimin fillor, të ndërtojë një mjedis gjithëpërfshirës ku çdo nxënës ndihet i mirëpritur dhe i mirëseardhur, të krijojë një klimë pozitive dhe me përdorimin e teknikave të disiplinimit pozitiv, ku nxënësit pranojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin, të dëshmojë interesimin e tij për t'u përditësuar me metodologjitë ndërvepruese të mësimdhënies, të përdorë metoda e instrumente të larmishme të vlerësimit të nxënësve. Ora e hapur e mësimit duhet të tregojë të gjitha aftësitë e mësuesit, përvojën e fituar dhe mjeshtërinë e tij në marrëdhënie me nxënësit dhe të nxënit e tyre. Kjo është një orë e cila pritet me kërshëri nga nxënësit, prindërit, kolegët, të ftuarit e mësuesit dhe vlerësuesit e cilësisë së saj. Prandaj krahas orientimeve dhe udhëzimeve që jepen çdo mësues që do të zhvillojë orë të hapur mësimi duhet të përgatitet fort për tri momente të rëndësishme të saj: Planifikimi i temës së mësimit, zhvillimi dhe shtrirja e saj nga minuti i parë deri në përfundim të orës së mësimit, punën me nxënësit dhe vlerësimin e rezultateve të arritjeve të tyre. Rezultatet e të nxënit janë pikënisja e planifikimit të orës së mësimit. Pra, nga njëra anë kemi mësuesin me përgatitjen e tij, nga ana tjetër janë nxënësit me demonstrimin e të nxënit, të aftësive të qëndrimeve të fituara gjatë orës së mësimit. Ndër elementet që duhet të mbajë parasysh mësuesi janë:

- Zhvillimi i një ore mësimi tërheqëse, ku secili di çfarë bën;
- Bashkëpunimi ndërmjet nxënësve, të nxënit në bashkëpunim dhe ndarja e ideve dhe komunikimi efektiv;
- Demonstrimi i vlerave të qytetarisë;

- Situata problemore ku nxënësve u duhet të mendojnë për t'u dhënë zgjidhje;
- Marrëdhënie pozitive, vetëkontroll dhe besim në vete. Pse jo edhe empati ndaj shokut/shoqes;
- Përdorimi i mjeteve digjitale, i tabletave ose i kompjuterëve; përdorimi i aplikacioneve në funksion të të nxënit;
- Situata reale, konkrete që i ndihmojnë më mirë nxënësit për të gjetur zgjidhje të reja;
- Diskutime të përshtatshme për moshën e nxënësve, bazuar në pyetje, hipoteza apo informacione të reja;
- Krijimi i një mjedisi i cili u mundëson nxënësve të punojnë në grupe dhe të lëvizin kur e kanë të nevojshme.
- Motivimi i vazhdueshëm i arritjeve të nxënësve, i përgjigjeve dhe rezultateve që përmbushin, çmuarja dhe shprehjet vlerësuese të veprimeve dhe sjelljeve të tyre.

## Orientime rreth planifikimit të orës së hapur të mësimit

Mësuesi është i lirë ta zgjedhë lëndën dhe temën e mësimit, të cilën do ta zhvillojë me nxënësit e klasës së tij. Gjithashtu, ai është i lirë ta zgjedhë vetë edhe mjedisin ku do ta zhvillojë mësimin me nxënësit për atë orë mësimi. Mësuesi do të vlerësohet:

- për respektimin e rubrikave të formatit të planifikimi ditor;
- për zbatimin praktik të këtij plani me nxënësit e klasës.

Gjatë trajnimeve për zbatimin e kurrikulës së re, mësuesit janë njohur edhe me formatin e ri të planifikimit vjetor, planifikimit të periudhës dhe planifikimit ditor.

Formati për planifikimin ditor sipas kurrikulës me kompetenca përmban rubrika të përcaktuara. Mësuesi është i lirë t'i organizojë këto rubrika në mënyrën që i duken më efektive. Në vijim renditen të gjitha rubrikat dhe jepen orientime dhe udhëzime që do ta ndihmojnë mësuesin të bëjë një planifikim sa më të mirë të temës mësimore, duke përfshirë risitë metodologjike për realizimin e rezultateve të të nxënit, si dhe risitë në procesin e të nxënit.

**Formati i planifikimit të temës mësimore për orën e hapur të mësimit**

| | | |
|---|---|---|
| **Lënda** | ➦ | Shënohet emërtimi i lëndës në të cilën do të zhvillohet ora e hapur mësimore. |
| **Tema mësimore** | ➦ | Shënohet tema e mësimit për atë orë mësimore. |
| **Rezultatet e të nxënit** | ➦ | Shkruhen rezultatet e të nxënit për këtë temë mësimore. Rezultatet duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme dhe të kuptueshme për atë që pritet të demonstrohet se është arritur nga nxënësi. |
| **Konceptet kyç/ fjalët kryesore** | ➦ | Shënohen konceptet kyç dhe fjalët kryesore që do të trajtohen gjatë zhvillimit të orës së mësimit. |
| **Situata e të nxënit** | ➦ | Përdorimi i situatave të të nxënit është një nga risitë e zbatimit të kurrikulës me kompetenca. Situata e të nxënit është e lidhur me veprimtari praktike që nxënësi zhvillon në klasë, ose një situatë e simuluar që lidhet me temën e mësimit. |

| | | |
|---|---|---|
| **Burimet, materialet dhe mjetet didaktike** | ➦ | Shënohen burimet e literaturës, materialet ndihmëse dhe mjetet didaktike që i duhen mësuesit dhe nxënësve gjatë zhvillimit të orës së mësimit. |
| **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare** | ➦ | Kjo rubrikë plotësohet kur tema e mësimit ka lidhje me njohuri nga lëndë të tjera të arsimit fillor ose me një nga temat ndërkurrikulare. Në raste të tilla, veprimtari lidhëse shënohet këtu, kurse integrimi me temën e mësimit trajtohet në rubrikën "Ecuria e zhvillimit të mësimit". |
| **Ecuria e zhvillimit të mësimit** | ➦ | Mësuesi shënon hap pas hapi të gjitha veprimtaritë që do të kryejë gjatë orës së mësimit. Gjithashtu në këtë rubrikë, mësuesi shënon veprimtaritë dhe metodat që do të përdoren prej tij dhe prej nxënësve të klasës. Pjesë e kësaj rubrike janë edhe mjetet digjitale që do të përdoren gjatë orës së mësimit. |
| **Vlerësimi** | ➦ | Mësuesi shënon për çfarë do t'i vlerësojë nxënësit apo për çfarë do të mbajë shënime vlerësuese gjatë zhvillimit të mësimit. Në kurrikulën e re, mësuesi përpiqet që gjatë gjithë kohës së mësimit t'i vendosë nxënësit në veprimtari praktike dhe në situata të tilla që ata të veprojnë e të demonstrojnë përmbushjen e rezultateve të të nxënit. Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi ndjek performancën e secilit prej tyre dhe bën vlerësime rreth saj. |
| **Detyra** | ➦ | Shënohen ushtrimet, kërkesat, temat, titujt e detyrave që do t'u jepen nxënësve për të punuar në shtëpi. Detyrat mund të jenë individuale ose në grup dhe t'u përgjigjen stileve të ndryshme të të nxënit. |

Sipas Nenit 25 të Udhëzimit të MAS-it Nr.17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", vlerësimi i orës mësimore të hapur për kandidatët e kategorisë "Mësues i kualifikuar" (Shtojca nr.1) dhe të kategorisë "Mësues specialist" (Shtojca nr.2) bëhet sipas Formatit të instrumentit për vlerësimin e orës së hapur, i cili

përmban; treguesit e cilësisë, përshkruesit, totalin e pikëve për secilin përshkrues dhe nivelet e vlerësimit.

**Udhëzime për plotësimin Formatit të instrumentit për vlerësimin e orës së hapur të mësimit për kategoritë "Mësues i kualifikuar" (Shtojca nr.1) dhe "Mësues specialist" (Shtojca nr.2)**

**Treguesi 1: Planifikimi i orës së hapur mësimore**

**Përshkruesi 1.** Mësuesi planifikon të gjithë komponentët e orës së mësimit në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënit.

*Mësuesi vlerësohet për:*

- përmbushjen e rezultateve të të nxënit të temës së mësimit;
- marrjen parasysh të nxënësve me aftësi dhe ritme të ndryshme përparimi;
- përshtatjen e situatës së të nxënit me përmbajtjen e temës së mësimit;
- për përzgjedhjen e materialeve dhe të mjeteve të përshtatshme për temën e mësimit;
- për qartësinë e hapave që do të ndjekë për zhvillimin e orës së mësimit;
- mbajtjen parasysh të përvojave e jetës së përditshme të nxënësve.

**Përshkruesi 2:** Mësuesi planifikon temën e mësimit me qasje të re inovative që lidhet me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore.

*Mësuesi vlerësohet për:*

- qasjen e re inovative që ka sjellë në zhvillimin e temës së mësimit;
- ndërveprimin mësues-nxënës dhe ndërmjet nxënësve me njëri-tjetrin;
- veprimtaritë e përzgjedhura për fillimin/hyrjen e mësimit dhe për vijimin e etapave të tjera të orës së mësimit;
- qartësinë në shpërndarjen dhe menaxhimin e kohës në dispozicion të secilës veprimtari të planifikuar;
- veprimtaritë që lidhen me zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës;
- veprimtaritë që lidhen me zhvillimin e kompetencave lëndore.

**Treguesi 2: Mjedisi i të nxënit**

**Përshkruesi 1.** Mësuesi krijon një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.

*Mësuesi vlerësohet për:*

- klimën që ka krijuar në klasë, ndërmjet tij dhe nxënësve të klasës dhe ndërmjet nxënësve në marrëdhënie me njëri-tjetrin;
- lirshmërinë që kanë nxënësit për të shfaqur mendimet dhe idetë e tyre për pyetje, situata dhe veprimtari të ndryshme;
- komunikimin dhe marrëdhëniet që kanë nxënësit ndaj njëri-tjetrit në situata, momente dhe veprimtari të ndryshme që zhvillohen në klasë.

**Përshkruesi 2.** Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.

*Mësuesi vlerësohet për:*

- drejtimin në emër të çdo nxënësi të klasës;
- përfshirjen e të gjithë nxënësve gjatë orës së mësimit;
- përgjigjet që u jep pyetjeve të nxënësve;
- vëmendjen që i kushton çdo nxënësi që ka nevojë;
- qetësinë që ruan në situata të vështira që kanë ndodhur gjatë orës së mësimit;
- përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuar dhe të nxënësve që paraqesin vështirësi në të nxënë.

**Treguesi 3: Metodat mësimore**

**Përshkruesi 1.** Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin.

*Mësuesi vlerësohet për:*

- përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimit;

- përdorimin e metodave dhe të teknikave që nxisin të menduarit kritik të  nxënësve;
- përdorimin e metodave që nxisin zgjidhje origjinale dhe stimulojnë aftësitë krijuese të nxënësve;
- temat, çështjet dhe rastet që sjell para nxënësve, të cilat nxisin biseda, diskutime dhe shprehjen e mendimeve të ndryshme.

**Përshkruesi 2.** Mësuesi formulon pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme duke nxitur nxënësit të bëjnë pyetje përgjatë orës së mësimit.

*Mësuesi vlerësohet për:*

- cilësinë e pyetjeve që u drejton nxënësve;
- larminë e pyetjeve, mbështetur në Taksonominë e Blumit, por jo vetëm;
- nxitjen e nxënësve për të bërë pyetje rreth asaj që dëgjojnë;
- kohën që u lë nxënësve të bëjnë pyetje, të japin përgjigje dhe të bëjnë diskutime

**Treguesi 4: Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve**

**Përshkruesi 1.** Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e tij të nxënies.

*Mësuesi vlerësohet për:*

- përmbushjen e rezultateve të të nxënit nga ana e nxënësve;
- mundësitë që iu krijuan çdo nxënësi për të treguar se çfarë mësoi nga ora e mësimit;
- qartësinë e nxënësve në kryerjen e detyrave dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin e veprimtarive gjatë orës së mësimit;
- dhënien e vlerësimeve që tregojnë çfarë ka bërë mirë nxënësi dhe ku duhet të përmirësohet më tej;
- përdorimin e teknikave që tregojnë se sa nxënësi e ka kuptuar përmbajtjen;
- analizën që bën në lidhje me arritjet e nxënësve të klasës.

**Përshkruesi 2.** Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të nxënësve.

*Mësuesi vlerësohet për:*

- përshtatjen e mësimdhënies dhe të veprimtarive sipas nevojave të nxënësve;
- motivimin e nxënësve për t'u përfshirë dhe për të përfunduar çdo detyrë;
- përshtatjen e metodave dhe të materialeve për të mundësuar që çdo fëmijë të përfitojë nga mësimi në klasë;
- përfshirjen e nxënësve në veprimtari, të cilat ata mund t'i kryejnë dhe të përmbushin rezultatet e të nxënit.

**Treguesi 5: Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale gjatë orës së mësimit**

**Përshkruesi 1.** Mësuesi përdor mjetet mësimore e didaktike për temën mësimore.

*Mësuesi vlerësohet për:*

- sigurimin e materialeve dhe mjeteve të planifikuara për temën e mësimit;
- përdorimin e materialeve vizuale, si postera, tabela, fotografi, video, skema të ndryshme etj.;
- konkretizimin e mësimit me mjete mësimore dhe didaktike të përshtatshme për temën e mësimit;

**Përshkruesi 2.** Mësuesi përdor mjete/materiale digjitale për të zhvilluar aftësitë e ndryshme të nxënësve.

*Mësuesi vlerësohet për:*

- sigurimin e materialeve dhe mjeteve që ka planifikuar të përdorë gjatë zhvillimit të orës së mësimit;
- motivimin dhe përfshirjen e nxënësve në ndërtimin e përmbajtjes nëpërmjet materialeve vizuale;
- lehtësimin e të nxënit të nxënësve duke përdorur tableta, kompjutera, laptopë, aplikacione e platforma në funksion të të nxënit;
- nxitjen e nxënësve për të zhvilluar aftësitë krijuese në realizimin e posterave, tabelave, diagrameve, paraqitjeve skematike, prezantimeve dhe punime të tjera që lidhen me temën e mësimit.

Kriteret e vlerësimit të orës së hapur mësimore

Në Shtojcën 1 të Udhëzimit të MAS-it Nr.17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë". jepet formati i instrumentit për vlerësimin e orës mësimore të hapur. Formati përmban Treguesit e cilësisë, Përshkruesit, Totalin e pikëve për secilin përshkrues, Nivelet e vlerësimit dhe Pikët e fituara nga mësuesi. Mësuesi duhet të fitojë 60% të pikëve të secilit komponent të orës së mësimit.

Kriteret e vlerësimit të orës së hapur mësimore:

- mbështesin mësuesit që do të kualifikohen për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe koordinatorit të cilësisë së shkollës për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës së hapur të mësimit, diskutimet, komentet, vlerësimet dhe sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive, të identifikojnë anët pozitive në zhvillimin e orës së mësimit dhe të përmirësojnë mësimdhënien në të ardhmen.

| Kriteret për vlerësimin e orës së hapur të mësimit për kategoritë "Mësues i kualifikuar" dhe "Mësues specialist" Gjithsej 30 pikë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Përshkruesit** | **Niveli 1 (Dobët)** | **Niveli 2 (Mjaftueshëm)** | **Niveli 3 (Mirë)** | **Niveli 4 (Shumë mirë)** |
| **Planifikimi i orës së hapur të mësimit (6 pikë)** | | | | |
| | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| **Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimit në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënit (3 pikë)** | • Planifikimi i temës së mësimit nuk është i plotë, organizimi i mësimit nuk është i qartë, rezultatet e të nxënit nuk kanë lidhje të ngushtë me temën e mësimit.<br>• Mungon situata e të nxënit dhe veprimtaritë nuk janë të lidhura me stilet e të nxënit.<br>• Mungon qartësia në renditjen e veprimtarive nga njëra etapë e mësimit në tjetrën. | • Mësuesi ka zbatuar pjesërisht kërkesat e planifikimit të temës mësimore.<br>• Situata e të nxënit nuk është e qartë. Veprimtaritë nuk janë të lidhura plotësisht me rezultatet e të nxënit.<br>• Planifikimi ka nevojë për një organizim më të mirë të veprimtarive dhe lidhjes së tyre me stilet e të nxënit. | • Mësuesi ka zbatuar pothuajse plotësisht kërkesat e planifikimit të temës mësimore.<br>• Rezultatet e të nxënit plotësojnë kriteret e shkrimit të tyre.<br>• Situata e të nxënit mundëson konkretizimin e mësimit dhe është e përshtatshme për temën e mësimit.<br>• Mësuesi është përpjekur të bëjë një planifikim të mirë, por janë lënë hapësira për | • Mësuesi ka zbatuar me korrektësi kërkesat e planifikimit të temës mësimore.<br>• Planifikimi është ndërtuar mbi bazën e rezultateve të të nxënit.<br>• Rezultatet e të nxënit janë shkruar në mënyrë korrekte.<br>• Situata e të nxënit mundëson konkretizimin e mësimit dhe lehtëson të nxënit e temës së mësimit nga nxënësit e klasës.<br>• Planifikimi ka një rrjedhë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | një renditje më të mirë të veprimtarive dhe përshtatje të tyre me stilet e të nxënit. | logjike dhe qartësi në kalimin nga njëra etapë e orës së mësimit në tjetrën.<br>• Gjatë planifikimit të veprimtarive, mësuesi ka mbajtur parasysh stile të ndryshme të të nxënit. |
| **Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | • Planifikimi i mësuesit nuk përbën qasje inovative për mësimdhënien në arsimin fillor.<br>• Veprimtaritë e zhvilluara nuk synojnë përmbushjen e kompetencave kyç dhe të lëndëve. | • Planifikimi i mësuesit ka pak përpjekje për të sjellë qasje inovative për mësimdhënien në arsimin fillor.<br>• Veprimtaritë e zhvilluara gjatë orës së mësimit kanë lidhje të dobëta me kompetencat e të nxënit gjatë gjithë jetës.<br>• Gjithashtu, veprimtaritë e zhvilluara tentojnë deri diku | • Mësuesi ka realizuar një planifikim të kujdesshëm, me elementë inovativë për mësimdhënien në arsimin fillor.<br>• Veprimtaritë e zhvilluara gjatë orës së mësimit kanë lidhje me kompetencat e të nxënit gjatë gjithë jetës.<br>• Gjithashtu, veprimtaritë u krijojnë mundësi | • Mësuesi ka realizuar një planifikim të kujdesshëm, i cili sjell risi në zhvillimin e mësimdhënies në arsimin fillor.<br>• Veprimtaritë e çdo etape të orës së mësimit nxisin te nxënësit shprehitë e komunikimit efektiv, të menduarit kritik e krijues dhe dëshirën e të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | të zhvillojnë te nxënësit kompetencat lëndore. | nxënësve të zhvillojnë kompetencat lëndore. | nxënit gjatë gjithë jetës.<br>• Planifiki mi ka mbajtur parasysh edhe zhvillimin e kompetencave lëndore. |
| **Mjedisi i të nxënit (6 pikë)** | | | | |
| **Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | • Mjedisit të klasës i mungon klima pozitive. Edhe pse përpiqet, mësuesi nuk arrin t'i përfshijë të gjithë nxënësit. Disa nxënës dominojnë mbi pjesën tjetër të klasës.<br>• Në përgjithësi pyetjet janë të nivelit riprodhues.<br>• Nxënësit mbrojnë mendimet që shfaqin dhe nuk reagojnë | • Mjedisi i klasës ka nevojë për klimë më pozitive. Edhe pse përpiqet, mësuesi nuk arrin t'i përfshijë të gjithë nxënësit. Disa nxënës dominojnë mbi pjesën tjetër të klasës.<br>• Në përgjithësi pyetjet edhe pse u drejtohen të gjithë nxënësve, për përgjigjet nuk mund të thuhet e njëjta gjë.<br>• Nxënësit mbrojnë | • Në klasë ndihet klima pozitive dhe fakti që nxënësit ndihen mirë. Ka raste kur mësuesi bën diferencime dhe aktivizon më shumë disa nxënës.<br>• Mësuesi përpiqet të pyesë dhe të përfshijë në veprimtari të gjithë nxënësit e klasës. Në përgjithësi nxënësit reagojnë mirë ndaj mendimit ndryshe. Mësuesi u kushton vëmendje të | • Në klasë ndihet klima pozitive dhe mbështetësi që mësuesi ka me nxënësit e klasës. Gjatë gjithë kohës, mësuesi i ka trajtuar nxënësit në mënyrë të barabartë, duke u kushtuar vëmendje, duke i pyetur dhe përfshirë në veprimtari të cilat ata i kanë kryer deri në fund.<br>• Nxënësit kanë marrëdhënie të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | pozitivisht ndaj mendimit ndryshe.<br>• Nxënësit nuk shprehin mendime as kur pyeten nga mësuesi. | mendimet që shfaqin dhe nuk reagojnë pozitivisht ndaj mendimit ndryshe.<br>• Nxënësit shprehin mendime kur pyeten nga mësuesi. | gjithë nxënësve, por më tepër nxënësve dhe i nxit të shprehin mendimet dhe idetë e tyre për situata dhe veprimtari që zhvillohen në klasë. | shëndetshme me njëri-tjetrin dhe reagojnë pozitivisht edhe kur ndërmjet tyre shfaqen mendime ndryshe.<br>• Nxënësit i shprehin lirshëm mendimet dhe idetë e tyre për pyetje, situata dhe veprimtari që zhvillohen në klasë. |
| **Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | • Mësuesi paraqet vështirësi në përfshirjen dhe angazhimin e nxënësve në veprimtaritë e planifikuara.<br>• Mungojn ë iniciativat dhe në përgjithësi nxënësit veprojnë sipas udhëzimeve që u jep mësuesi. | • Mësuesi përpiqet t'i përfshijë nxënësit në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në klasë. Mungojnë iniciativat dhe në përgjithësi nxënësit veprojnë sipas detyrave që u jep mësuesi. | • Në përgjithësi, mësuesi u drejtohet nxënësve me emër. Në pjesën më të madhe të kohës, çdo nxënës është i përfshirë në veprimtaritë që zhvillohen në klasë. Nxënës të veçantë kërkojnë të marrin | • Në çdo rast mësuesi u drejtohet nxënësve me emër. Të gjithë nxënësit e klasës u përfshinë në mënyra, detyra dhe veprimtari të ndryshme, të cilat ishin planifikuar kujdesshëm nga mësuesi. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **përgjigje me kujdes (3 pikë)** | • Mësuesi nuk nxit diskutime mes nxënësve dhe pothuajse në çdo rast është ai që e drejton mësimin, bisedën dhe çdo veprimtari tjetër. | • Mësuesi nuk nxit diskutimin mes nxënësve dhe pothuajse në çdo rast është ai që e drejton mësimin, bisedën dhe veprimtarinë. • Herë-herë bie në sy prirja e mësuesit për të përfshirë në mësim nxënësit me aftësi të kufizuar, duke mos u dhënë të njëjtën vëmendje nxënësve të tjerë të klasës. | iniciativa në kryerjen e detyrave të ndryshme. • Në përgjithësi, pyetjeve të nxënësve u përgjigjet vetë mësuesi dhe rrallë përfshin nxënësit e tjerë. • Kujdeset për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuar dhe të nxënësve që paraqesin vështirësi në të nxënë. | • Nxënësit sillen natyrshëm dhe përfshihen në nisma, bëjnë pyetje dhe përfundojnë çdo detyrë që u jepet. • Mësuesi vetë ose nëpërmjet nxënësve të tjerë u përgjigjet pyetjeve që bëjnë nxënësit. • Menaxhon situatat e vështira/të papritura dhe e ka klasën në kontroll. • Kujdeset për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuar dhe të nxënësve që paraqesin vështirësi në të nxënë. |
| **Metodat e mësimdhënies (6 pikë)** | | | | |
| **Mësuesi përdor metoda që** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | • Metodat që përdor mësuesi nuk | • Mësuesi drejton pyetje që nxisin të | • Mësuesi përdor disa metoda dhe | • Mësuesi përdor metoda që nxisin |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (3 pikë)** | nxisin të menduarit e nxënësve, por vetëm riprodhime të informacioneve që trajtohen në mësim.<br>• Mungon kërkesa e mësuesit për nxënësit që të japin ide dhe zgjidhje origjinale.<br>• Detyrat që kryejnë nuk i nxisin nxënësve të menduarit dhe aftësitë e tyre krijuese.<br>• Diskutimet janë të vakëta dhe mbyllen shpejt, me mungesë argumentesh. | menduarit e nxënësve, por pa kërkuar të analizojnë, të përgjithësojnë apo të nxjerrin mësime e përfundime për situatat e dhëna.<br>• Herë-herë mësuesi i nxit nxënësit të japin zgjidhje origjinale dhe të mbajnë qëndrime individuale.<br>• Gjithashtu, metodat e mësimdhënies stimulojnë deri diku zhvillimin e aftësive krijuese të nxënësve.<br>• Më tepër, mësuesi zhvillon biseda, sesa diskutime për dhënie mendimesh të ndryshme. | teknika të cilat nxisin të menduarit kritik të nxënësve.<br>• Në disa raste mësuesi nxit dhënien e zgjidhjeve origjinale dhe mbajtjen e qëndrimeve individuale të nxënësve në situatat e dhëna.<br>• Gjithashtu, metodat e mësimdhënies stimulojnë deri diku zhvillimin e aftësive krijuese të nxënësve.<br>• Mësuesi përpiqet të ndezë në klasë diskutime për t'i përfshirë nxënësit në trajtimin e pyetjeve dhe të çështjeve që po diskutohen. | ndërveprimin me nxënësit.<br>• Mësuesi përdor metoda dhe teknika që nxisin të menduarit kritik të nxënësve dhe zgjidhje origjinale të situatave të ndryshme.<br>• Gjithashtu, metodat e mësimdhënies stimulojnë zhvillimin e aftësive krijuese të nxënësve dhe integrimin ndërlëndor.<br>• Temat, çështjet, pyetjet dhe rastet që sjell para nxënësve, nxisin biseda, diskutime dhe shprehjen e mendimeve të ndryshme të nxënësve. |

| | 0 pikë | 1 pikë | 2 pikë | 3 pikë |
|---|---|---|---|---|
| **Mësuesi formulon pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme duke nxitur nxënësit të bëjnë pyetje përgjatë orës së mësimit (3 pikë)** | • Mësuesi drejton kryesisht pyetje që kërkojnë nga nxënësit riprodhimin e informacionit. • Mungojnë pyetje që nxisin nivelet e larta të të menduarit dhe sidomos pyetjet vlerësuese dhe krijuese. • Pyetjet e mësuesit janë në përgjithësi të mbyllura dhe jo të hapura. • Mungojnë pyetjet e drejtuara nga nxënësit. | • Mësuesi u drejton nxënësve pyetje kryesisht të nivelit bazë dhe mesatar të Taksonomisë së Blumit. • Mësuesi i nxit nxënësit t'i bëjnë pyetje, por duket që ato nuk janë praktikë e përditshme në këtë klasë. • Mësuesi nuk diferencon kohën që u duhet nxënësve për t'u përgjigjur në varësi të llojit të pyetjeve që u drejton. | • Mësuesi u drejton nxënësve pyetje të niveleve të ndryshme të Taksonomisë së Blumit, por në përgjithësi mbizotërojnë pyetjet e nivelit mesatar të të menduarit. • Vazhdimisht mësuesi i nxit nxënësit të bëjnë pyetje. • Mësuesi u lë kohë nxënësve të mendohen para se të përgjigjen, por herë-herë ajo nuk mjafton dhe nxënësit nuk e shprehin të plotë mendimin që kanë. • Mësuesi drejton pyetje të hapura nëpërmjet të cilave nxit qëndrime e | • Mësuesi u drejton nxënësve pyetje të niveleve të ndryshme të Taksonomisë së Blumit. • Pyetjet fillojnë nga niveli bazë, mesatar dhe shkojnë deri te niveli i lartë i të menduarit. • Gjithashtu, mësuesi i nxit nxënësit t'i drejtojnë atij pyetje, por edhe nxënësve të tjerë të klasës. • Në varësi të nivelit të pyetjes, mësuesi u lë kohë nxënësve të mendohen para se të përgjigjen. • Pjesa më e madhe e pyetjeve janë të hapura dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | veprime individuale të nxënësve. | lidhen me qëndrime e veprime individuale të nxënësve. |
| **Vlerësimi i nxënësve (6 pikë)** | | | | |
| | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| **Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e tij të nxënies (3 pikë)** | • Mësuesi bën vlerësime të nxënësve për veprimtaritë e zhvilluara, detyrat e kryera. • Të gjitha vlerësimet janë të shkurtra dhe nuk nxjerrin në dukje vështirësitë e nxënësve dhe drejtimet ku kanë nevojë për përmirësim. • Vlerësimi i mësuesi është i përqendruar në pak nxënës dhe pjesa më e madhe e klasës mbetet pa vlerësim. • Nxënësit paraqesin vështirësi të mëdha për të | • Vlerësimi i mësuesit është i përqendruar vetëm në ato veprimtari që kanë lidhje me përmbushjen e rezultateve të të nxënit të temës së mësimit. • Edhe pse i pyet, nxënësit paraqesin vështirësi për të kuptuar se çfarë kanë të paqartë apo të pa kuptuar prej tyre. • Të pakta janë rastet kur mësuesi bën vlerësime pozitive rreth punës që kryejnë nxënësit. | • Vlerësimi i mësuesit është i përqendruar te përmbushja e rezultateve të të nxënit të temës mësimore. • Mësuesi i pyet vazhdimisht nxënësit nëse kanë diçka të paqartë apo të pa kuptuar prej tyre. • Herë pas here, mësuesi u bën nxënësve vlerësime pozitive rreth punës që kryejnë. • Nxënësit i tregojnë vështirësitë kur pyeten nga mësuesi. | • Mësuesi i vlerëson nxënësit për përmbushjen e rezultateve të të nxënit të temës mësimore. • Mësuesi u lë nxënësve kohë të përmbledhin çfarë kanë mësuar, si dhe u kërkon të nxjerrin në pah çfarë nuk kanë kuptuar. • Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi bën vlerësime pozitive rreth punës që kryejnë, duke i nxitur dhe stimuluar vazhdimisht që të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | treguar çfarë kanë të paqartë. | | | bëjnë më të mirën.<br>• Nxënësit kuptojnë vështirësitë dhe kërkojnë ndihmë kur kanë nevojë.<br>• Mësuesi stimulon edhe vetëvlerësimin e nxënësve.<br>• Mësuesi vlerëson marrëdhëniet dhe cilësitë e tjera të nevojshme të punës në grup. |
| Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të nxënësve **(3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | • Mësuesi jep detyra të njëjta për të gjithë nxënësit, pa marrë parasysh stilet e të nxënit apo nevojat e tyre individuale. | • Mësuesi i përfshin nxënësit në veprimtari të përbashkëta. Pak prej tyre u përkasin nevojave individuale dhe stileve të ndryshme të të nxënit.<br>• Jo të gjithë nxënësit i realizojnë detyrat | • Mësuesi njeh nxënësit e klasës dhe veprimtaritë e planifikuara u përkasin nevojave të tyre dhe stileve të të nxënit.<br>• Mësuesi u mundua që të gjithë nxënësit të ndiheshin mirë.<br>• Gjatë orës së mësimit | • Mësuesi njeh nxënësit e klasës dhe ka planifikuar edhe detyra të diferencuara, të cilat u përkasin nevojave të tyre dhe stileve të të nxënit.<br>• Mësuesi e përshtat mësimdhënien dhe të gjitha veprimtaritë dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | e dhëna nga mësuesi. | pjesa më e madhe e nxënësve u përfshi në kryerjen e detyrave të klasës. | bën të mundur që të gjithë nxënësit të ndihen mirë.<br>• Gjatë orës së mësimit të gjithë nxënësit përfshihen dhe kryejnë detyrat e dhëna nga mësuesi. |
| **Përdorimi i mjeteve (didaktike dhe digjitale) (6 pikë)** | | | | |
| **Mësuesi përdor mjetet mësimore e didaktike për temën mësimore (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | • Mësuesi përdor shumë pak mjete mësimore, didaktike. Mungesa e tyre e kufizon nga njëra anë mësuesin për konkretizimin e mësimit dhe nga ana tjetër nxënësit për kryerjen e veprimtarive dhe përmbushjen e rezultateve të të nxënit. | • Mësuesi përdor pak mjete mësimore, ndërkohë që tema e mësimit ka hapësirë edhe për materiale të tjera didaktike.<br>• Mungesa e mjeteve dhe materialeve të nevojshme kufizon deri diku mësuesin dhe nxënësit për realizimin e veprimtarive dhe përmbushjen e rezultateve të të nxënit të temës së mësimit. | • Mësuesi ka siguruar materiale dhe mjete që lidhen me veprimtari të caktuara të orës së mësimit.<br>• Nëpërmjet tyre, tema e mësimit është e konkretizuar dhe nxënësit janë të nxitur të ndjekin me interes çdo etapë të orës së mësimit. | • Mësuesi ka siguruar të gjitha materialet dhe mjetet që lidhen me temat e mësimit.<br>• Nëpërmjet tyre ai konkretizon mësimin dhe lehtëson të nxënit e nxënësve. |

| | 0 pikë | 1 pikë | 2 pikë | 3 pikë |
|---|---|---|---|---|
| **Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve (3 pikë)** | • Mësuesi nuk përdor mjete digjitale gjatë zhvillimit të temës së mësimit. • Mësuesi nuk ka dijeni nëse nxënësit kanë ose jo aftësi digjitale të cilat mund t'i përdorin në kryerjen e detyrave të ndryshme. | • Mësuesi i përdor me ndihmën e të tjerëve mjetet digjitale por herë-herë situata i doli jashtë kontrollit. • Nxënësit nuk arrijnë të vënë në zbatim aftësitë e tyre digjitale. | • Mësuesi ka siguruar pajisjet dhe mjetet digjitale që i duhen për zhvillimin e orës së mësimit. • Mësuesi përdor me pak vështirësi mjetet dhe përpiqet t'i mbajë nxënësit të përfshirë në mësim. • Mësuesi u përpoq të përfshinte nxënësit me aftësi digjitale në disa momente të orës së mësimit. • Mësuesi u dha nxënësve detyrë për ta realizuar me mjete digjitale. | • Mësuesi përdor mjete digjitale, aplikacione dhe/ose platforma online për të zhvilluar orën e mësimit. • Mësuesi i përdori mjetet me siguri të plotë dhe mbajti gjallë interesin e nxënësve për çdo veprimtari. • Mësuesi arriti të përdorë aftësitë digjitale të nxënësve në kryerjen e detyrave të klasës. • Mësuesi i nxit nxënësit të realizojnë detyra duke përdorur mjetet digjitale. |

## Orientime dhe udhëzime për projektin kurrikular–Kategoritë "Mësues specialist" dhe "Mësues mjeshtër"

Projekti kurrikular është punë kërkimore, hulumtuese dhe krijuese, i cili nxit nxënësit të marrin iniciativa për të vepruar, menduar dhe për të realizuar. Të gjitha projektet burojnë nga interesat e nxënësve, nga temat mësimore të zhvilluara në lëndë të ndryshme apo nga pyetjet që u lindin në mendje. Zhvillimi i projekteve në arsimin fillor ndihmon në zhvillimin e aftësive të ndryshme, por gjithashtu i bën nxënësit të ndihen të lidhur me procesin e të mësuarit dhe të motivuar për të eksploruar botën rreth tyre. Mësuesit nxisin projekte që zgjerojnë dhe sfidojnë të nxënit e nxënësve, zhvillimin e tyre fizik, emocional dhe social. Projektet kurrikulare zhvillojnë aftësitë e të menduarit të nxënësve, aftësitë krijuese, ngritjen e hipotezave, bërjen e pyetjeve, analizat, zgjidhjen e problemeve, duke u krijuar mundësi nxënësve të shfaqin veten në të gjitha dimensionit. Krahas këtyre aftësive projekti zhvillon te nxënësit formimin e vlerave, të normës etike në marrëdhënie me të tjerët, të pranimit të ndryshimeve në interes të përbashkët, të qytetarisë duke mësuar të jetojnë, të punojnë dhe të ndajnë sukseset dhe arritjet së bashku.

Për të realizuar më së mirë një projekt kurrikular me nxënësit e arsimit fillor, mësuesi duhet të ketë parasysh:

- qartësinë e qëllimeve;
- rezultatet e pritshme;
- detajimin e planit;
- pjesëmarrjen dhe përfshirjen aktive të të gjithë nxënësve;
- përshtatshmërinë e metodave dhe të teknikave;
- motivimin e nxënësve;
- përshtatjen e mjediseve;
- kriteret e vlerësimit;
- produktin dhe mënyrën e prezantimit të rezultateve të projektit.

## Struktura dhe përmbajtja e rubrikave të projektit kurrikular

| | |
|---|---|
| **Tema e projektit** | Shkruhet tema e projektit që do të punohet me nxënësit. Tema e projektit është e afërt me interesat, përvojat, ngjarjet dhe mjedisin rrethues të nxënësve dhe bën të mundur që secili prej tyre të jetë i angazhuar plotësisht në realizimin e tij. Në arsimin fillor, projekti duhet të jetë ndërkurrikular dhe të përfshijë disa lëndë mësimore.<br>Projekti mund të ketë një histori të shkurtër të lindjes së tij dhe të interesit që ngjalli te nxënësit. |
| **Qëllimet e projektit dhe rezultatet e të nxënit** | Mësuesi luan një rol aktiv në prezantimin e projektit dhe sigurimin e udhëzimeve të qarta për qëllimet e tij. Ai shpjegon konceptet kryesore dhe përfshin nxënësit në diskutime për t'u siguruar që ata e kuptojnë temën dhe synimet e projektit. Qëllimet e projektit janë të lidhura me dëshirat dhe pritshmëritë për rezultatet që do të arrihen.<br>Rezultatet e të nxënit shënohen për çdo lëndë që përfshihet në realizimin e projektit. |
| **Kohëzgjatja e projektit** | Në arsimin fillor, projekti mund të zhvillohet brenda një periudhe nisur nga mosha e nxënësve, por nuk përjashtohet që projekti të jetë i shtrirë gjatë gjithë vitit, me tri tema madhore që zhvillohen në secilën periudhë të vitit. Në projektet ndër lëndore, përcaktohet numri i orëve nga secila lëndë. |
| **Planifikimi i projektit** | Projekti është i lidhur sa me përgatitjen e mësuesit, aq edhe me punën e nxënësve. Në draftimin e projektit mësuesi duhet të mbajë parasysh:<br>• **Rezultatet e të nxënit**: Çfarë dëshiron/pret të arrijnë nxënësit nga projekti në çdo lëndë; Cilat janë aftësitë dhe njohuritë që duhet të ndërtojnë/zhvillojnë nxënësit gjatë këtij projekti.<br>• **Veprimtaritë**: Ideimi i veprimtarive kryesore që lidhen me çështjet që do të trajtohen/punohen/zhvillohen nga nxënësit javë pas jave.<br>• **Krijimin e mundësive** për zhvillimin e kërkimeve, diskutimin rreth gjetjeve, grumbullimin e materialeve, organizimin e tyre etj. Në arsimin fillor, këto veprimtari hulumtuese ndodhin sa brenda klasës, aq edhe në shtëpi apo në mjedise të tjera të parashikuara në projekt.<br>• **Mundësitë e bashkëpunimit të nxënësve** në grupe të vogla, duke u |

| | |
|---|---|
| | përfshirë në detyra të caktuara dhe duke punuar për qëllimet e përbashkëta.<br>• **Burimet kryesore të informacionit, por edhe burimet e nevojshme njerëzore:** Identifikimi i materialeve, mjeteve, videove, filmimeve, fotografive, librave, vizitave, ekskursioneve, eksperimenteve, intervistave, pyetësorëve dhe i burimeve të nevojshme që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit në faza të tij të ndryshme; nevojat për ndihmë dhe mbështetje nga nxënës më të rritur, familjarë dhe komunitet.<br>• **Temat mësimore, konceptet dhe njohuritë nga programet mësimore:** Njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet që zhvillon projekti në çdo lëndë është bërë pjesë e realizimit të tij. |
| **Zbatimi i projektit** | Në realizimin e projektit mësuesi kujdeset për:<br>• **Krijimin e një kalendari aktivitetesh**. Mësuesi ndihmon nxënësit të planifikojnë një kalendar me aktivitete të caktuara, afate kohore dhe persona përgjegjës, duke i mësuar njëherazi si të menaxhojnë kohën e tyre dhe t'i japin rëndësi aktiviteteve.<br>• **Vëzhgimin** e punës individuale dhe kontributin që jep çdo nxënës në punën në grup. Gjatë realizimit të projektit, mësuesi mbikëqyr dhe vëzhgon veprimtaritë e nxënësve. Vëzhgimi i siguron mësuesit informacion për përfshirjen e nxënësve, bashkëpunimin, ndihmën që i japin njëri-tjetrit, përballimin e sfidave, punën kërkimore që kryejnë, ndjekjen e hapave të projektit dhe aftësitë krijuese.<br>• **Monitorimin e progresit të nxënësve**. Mësuesi ndjek progresin e nxënësve në çdo lëndë dhe për çdo detyrë që ai/ajo angazhohet. Mësuesi përqendrohet në nevojat e secilit nxënës dhe u jep atyre mundësi për të eksploruar sipas ritmit individual. |
| **Produkti final** | Përgatitja e produktit final të një projekti është një hap i rëndësishëm që përfshin bashkëpunimin mes mësuesit dhe nxënësve.<br><br>*a) Disa aspekte që duhet të mbahen parasysh nga mësuesi:* |

| | |
|---|---|
| | ▪ **Qëllimet e projektit.** Mësuesi duhet të sigurojë që produkti final të përputhet me qëllimet dhe rezultatet e projektit. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e punës së tyre.<br>▪ **Përfshirja e nxënësve.** Mësuesi duhet të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në përgatitjen e produktit final, duke i lejuar ata të kontribuojnë me idetë e tyre dhe të marrin vendime në lidhje me procesin organizues të materialeve dhe krijues.<br>▪ **Materialet dhe mjetet.** Sigurimi i materialeve dhe mjeteve të nevojshme për të realizuar produktin final. Mësuesi duhet të jetë i vetëdijshëm për nevojat dhe mundësitë e nxënësve në zgjedhjen e materialeve.<br>▪ **Sigurimi i mbështetjes.** Mësuesi duhet të ofrojë udhëzime dhe mbështetje gjatë procesit të përgatitjes së produktit final, duke i ndihmuar nxënësit të përballen me sfidat dhe të zhvillojnë aftësi të reja.<br>▪ **Pjesëmarrja e prindërve.** Mësuesi duhet të inkurajojë përfshirjen e prindërve në procesin e zhvillimit të projektit në faza të ndryshme të tij, duke ndihmuar me materialet ose duke ofruar ide dhe burime.<br>▪ **Vlerësimi dhe reflektimi.** Mësuesi planifikon mënyrën e vlerësimit të punës së kryer gjatë projektit dhe produktin final. Ai i nxit nxënësit të reflektojnë për gjithë ecurinë e projektit duke i pyetur për sfidat dhe sukseset që kanë hasur gjatë punës së tyre.<br><br>*b) Disa aspekte që duhet të mbajnë parasysh nxënësit:*<br><br>▪ **Krijimi i ideve.** Nxënësit duhet të inkurajohen të shprehin idetë e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin e produktit final. Kjo i ndihmon të ndihen të përfshirë dhe të vlerësuar.<br>▪ **Pjesëmarrja aktive.** Nxënësit duhet të përfshihen në aktivitete, të tregojnë përkushtim dhe të bashkëpunojnë me shokët e tyre.<br>▪ **Përdorimi i materialeve.** Nxënësit duhet të eksplorojnë dhe të përdorin materiale të ndryshme për të realizuar produktin e tyre, duke u njohur me teknika të reja dhe mënyra të ndryshme krijuese. |

| | |
|---|---|
| | ▪ **Komunikimi dhe bashkëpunimi.** Nxënësit duhet të praktikojnë komunikimin dhe bashkëpunimin me shokët e tjerë. Kjo është e rëndësishme për të ndarë ide dhe për të punuar si një ekip.<br>▪ **Reflektimi mbi procesin.** Nxënësit duhet të reflektojnë mbi atë që kanë mësuar gjatë procesit dhe si kanë kontribuar në produktin final. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë vlerën e punës së tyre dhe përmirësimin që mund të bëjnë në të ardhmen.<br>▪ **Kënaqësia dhe gëzimi.** Nxënësit duhet të fokusohen në kënaqësinë dhe gëzimin që sjell përgatitja e produktit final. Muaj të tërë punë që prezantohen në një produkt të vetëm. Një qëndrim pozitiv ndihmon në rritjen e motivimit dhe të angazhimit në projekte të reja.<br>▪ **Prezantimi i produktit.** Nxënësit duhet të përgatiten për të prezantuar produktin e tyre përpara të tjerëve. Kjo mund të jetë një mundësi për të zhvilluar aftësinë e komunikimit dhe të ndihen të rëndësishëm në atë që kanë krijuar. |
| **Portofoli i nxënësit** | Në portofolin e tij, nxënësi duhet të ketë shembuj të punës që ka kryer gjatë gjithë shtrirjes dhe kohëzgjatjes së projektit. Portofoli përmban:<br>• titullin e projektit;<br>• një përmbledhje të shkurtër me qëllimet individuale të nxënësit;<br>• pyetjet kryesore (hipotetike) ose problemi mbi të cilin do të realizohet projekti);<br>• burimet që janë përdorur gjatë projektit për të mbledhur informacion për pyetjet kërkimore;<br>• materialet e përdorura për realizimin e produktit final;<br>• plani i punës së nxënësit me veprimtaritë për secilën fazë të projektit (planifikimi, kërkimi, realizimi dhe prezantimi);<br>• përshkrime, fotografi, vizatime, informacione që kanë shërbyer për realizimin e projektit;<br>• reflektime personale të nxënësit në lidhje me ecurinë dhe zhvillimin e projektit. |
| **Përfundimi dhe prezantimi** | Përgatitja e produktit final të një projekti është mundësi shumë e mirë për të forcuar lidhjen mes mësuesit dhe nxënësve, duke inkurajuar kreativitetin dhe përfshirjen e tyre. Për të realizuar prezantime cilësore, nxënësit |

| | |
|---|---|
| **i projektit** | zhvillojnë aftësi që ndihmojnë në rritjen e besimit gjatë komunikimit dhe prezantimit.<br><br>**Aftësitë e komunikimit**<br>• **Fjalori**. Përdorimi i gjuhës së përshtatshme, i terminologjisë së duhur. Artikulimi i qartë, i plotë i mendimeve.<br>• **Aftësitë e të dëgjuarit**. Mësuesi ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e të dëgjuarit për të kuptuar më mirë pyetjet dhe reagimet e 'publikut'.<br><br>**Shprehja verbale dhe jo-verbale**<br>• **Toni i zërit**. Përdorimi i tonit të duhur të zërit për të theksuar pikat kyçe, për të menaxhuar emocionet dhe për të mbajtur vëmendjen e audiencës.<br>• **Gjuha e trupit**. Përdorim i gjuhës së trupit dhe i mimikës për të përcjellë mesazhe.<br><br>**Strukturimi i informacionit**<br>• **Organizimi i prezantimit**. Mësuesit i ndihmojnë nxënësit të organizojnë idetë, mendimet dhe punimet e tyre në mënyrë logjike, duke filluar nga hyrja, përshkrimi i detajeve dhe nxjerrja e përfundimeve.<br>• **Përdorimi i ndihmës vizuale**. Nxitja e nxënësve të përdorin materiale vizuale për të lehtësuar të kuptuarin e informacionit që prezantohet.<br><br>**Besimi në vetvete**<br>• **Motivimi i nxënësve**. Nxënësit ndihmohen të ndihen të sigurt dhe të besojnë në aftësitë e tyre, duke i lavdëruar dhe mbështetur gjatë praktikave të prezantimit.<br>• **Simulimi i situatave**. Krijimi i mundësive për nxënësit të praktikojnë prezantimin e projektit në një mjedis të sigurt për ta.<br><br>**Aftësitë e bashkëpunimit** |

| | |
|---|---|
| | • **Puna në grup**. Nxitja e nxënësve të punojnë së bashku për të zhvilluar veprimtaritë në çdo fazë të projektit.<br>• **Përgatitja e veprimtarive të grupit**. Krijimi i mundësive për të ndihmuar njëri-tjetrit gjatë përgatitjes së prezantimeve.<br><br>**Menaxhimi i stresit dhe emocioneve**<br>• **Teknikat e qetësisë**. Mësimi i teknikave të thjeshta për të menaxhuar stresin dhe emocionet, si frymëmarrja e thellë, përpara se të flasin përpara 'audiencës'.<br>• **Përballja me frikën.** Nxënësit ndihmohen të përballen me frikën e fjalimit në publik duke u praktikuar shpesh dhe duke u inkurajuar të flasin para klasës ose para nxënësve të klasave të tjera.<br><br>**Vlerësimi dhe reflektimi**<br>• **Vlerësimi i performancës**. Pas përfundimit të prezantimit të projektit, nxënësit mund të reflektojnë mbi atë që kanë bërë dhe si u prit projekti i tyre. Kjo ndihmon në rritjen e vetëbesimit dhe zhvillimin e vetëvlerësimit të tyre.<br>• **vlerësime nga mësuesi dhe të ftuarit**. Krijimi i mundësive për të marrë feedback konstruktiv nga të tjerët për të përmirësuar aftësitë e prezantimit. |
| **Partneriteti mësues-prind** | Prindërit luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e nxënësve dhe kontribuojnë në zhvillimin e tyre të përgjithshëm. Në zbatimin e projekteve duhet:<br><br>**Komunikim i rregullt**<br>• **Informimi për projektin**: Mësuesit duhet të komunikojnë qartë me prindërit për projektin, qëllimet e tij dhe mënyrat se si ata mund të kontribuojnë. Kjo mund të bëhet përmes takimeve, letrave, ose komunikimeve në grupe të dedikuara online.<br>• **Rrjetet sociale dhe aplikacionet**: Përdorimi i platformave të komunikimit online për të ndarë informacion rreth aktiviteteve, rezultateve dhe ecurisë së projektit. |

| | |
|---|---|
| | **Pjesëmarrje aktive**<br>• **Kontributi në aktivitete**: Prindërit mund të angazhohen në aktivitete të ndryshme ose në ofrimin e njohurive dhe të përvojave të tyre për temën e projektit.<br>• **Vullnetarizmi**: Prindërit mund të ofrojnë ndihmë si vullnetarë në klasë, duke mbështetur mësuesin dhe nxënësit në zbatimin e aktiviteteve të projektit.<br><br>**Pjesëmarrje në aktivitete jashtë klasës**<br>• **Ekskursione dhe vizita**: Prindërit mund të ndihmojnë në organizimin e ekskursioneve ose të vizitave që lidhen me temën e projektit. Kjo u jep nxënësve mundësinë të eksplorojnë më shumë dhe të ndihen më të sigurt në praninë e prindërve.<br>• **Ngjarje dhe aktivitete në komunitet**: Pjesëmarrja e prindërve në aktivitete të organizuara në komunitet mund të forcojë lidhjen midis shkollës dhe komunitetit.<br><br>**Kontribut me burime**<br>• **Materiale dhe mjete**: Prindërit mund të ofrojnë materiale të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve, si p.sh. libra, mjete artizanale ose ndihmë për të siguruar burime të tjera që lidhen me temën e projektit.<br>• **Ekspertë nga familja**: Nëse ndonjë nga prindërit ka ekspertizë në një fushë të caktuar, ata mund të ndihmojnë duke ofruar informacion dhe përvoja praktike për nxënësit.<br><br>**Diskutime në shtëpi**<br>• **Ndarja e informacionit**: Prindërit mund të inkurajohen të flasin me fëmijët e tyre për projektin, duke ndihmuar në forcimin e lidhjes mes shkollës dhe shtëpisë. Kjo ndihmon në përforcimin e njohurive që nxënësit marrin në klasë. |

| | |
|---|---|
| | • **Veprimtaritë në shtëpi**: Prindërit mund të krijojnë mundësi për aktivitete të ngjashme me ato që bëhen në klasë, duke inkurajuar nxënësit të eksperimentojnë dhe të mësojnë më shumë në mjedisin familjar.<br><br>**Vlerësim dhe reflektim**<br>• **Feedback dhe sugjerime**: Prindërit mund të ofrojnë feedback mbi përvojat e nxënësve në projekt dhe të sugjerojnë mënyra për përmirësimin e aktiviteteve në të ardhmen.<br>• **Vlerësimi i rezultateve**: Prindërit mund të diskutojnë me nxënësit për atë që kanë mësuar dhe si mund t'i zbatojnë njohuritë e reja në jetën e tyre të përditshme.<br><br>**Krijim i një atmosfere mbështetjeje**<br>• **Inkurajimi i pjesëmarrjes**: Prindërit duhet t'i inkurajojnë nxënësit të angazhohen aktivisht në projekt dhe të shprehin mendimet e tyre. Një atmosferë mbështetjeje ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit te nxënësit.<br>• **Krijimi i një marrëdhënieje të fortë**: Prindërit që angazhohen në projekte ndihmojnë në ndërtimin e një marrëdhënieje më të fortë me nxënësit e tyre, duke u dhënë atyre mundësinë të shprehin veten dhe të ndihen të vlerësuar. |
| **Arritja e rezultateve të të nxënit dhe reflektimi mbi përvojën e fituar** | Vlerësimi i interesit, i kënaqësisë dhe i përkushtimit të nxënësve parashkollorë gjatë zhvillimit të projekteve është një proces i shumanshëm që kërkon përdorimin e metodave dhe të teknikave të ndryshme. Këto vlerësime ndihmojnë mësuesit të kuptojnë nevojat dhe interesat e nxënësve, duke ndihmuar kështu në krijimin e një mjedisi të nxëni më stimulues dhe përmbushës.<br>• **Prezantimi i rezultateve**: Mësuesi dhe nxënësit organizojnë një aktivitet në të cilin nxënësit prezantojnë rezultatet e projektit. Nxënësit tregojnë si ndihen teksa paraqesin punën e tyre, duke dhënë njëkohësisht informacion mbi interesin dhe përkushtimin e tyre ndaj temës së projektit. |

| | |
|---|---|
| | • **Rrëfimet dhe përjetimet**: Nxënësit ndajnë përjetimet e tyre në lidhje me projektin dhe çfarë kanë mësuar përgjatë zbatimit të tij.<br>• **Vlerësimi i rezultateve**: Mësuesi ndihmon nxënësit të vlerësojnë arritjet e tyre, duke diskutuar se çfarë kanë mësuar dhe si kanë kontribuar në grup. Kjo ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit dhe vetëvlerësimit.<br>• **Prezantimi i produkteve**: Mësuesi organizon një prezantim ku nxënësit mund të tregojnë punën e tyre dhe të flasin për atë që kanë mësuar, duke ndihmuar në zhvillimin e aftësive të komunikimit dhe të prezantimit.<br>• **Reflektimi mbi procesin e të nxënit**: Mësuesi nxit nxënësit të reflektojnë mbi përvojat e tyre dhe të diskutojnë se si mund t'i zbatojnë atë që kanë mësuar në aktivitete të tjera në të ardhmen. |

## Vlerësimi i projektit kurrikular

A. **Treguesi i cilësisë: Demonstrimi nga nxënësit i aftësive hulumtuese, kërkimore, krijuese**

**Kërkimi** është procesi i identifikimit të problemit, i formulimit të pyetjeve hulumtuese dhe i kërkimit të përgjigjeve në mënyrë të strukturuar. Gjatë fazës së kërkimit, nxënësit mësojnë të formulojnë pyetje kërkimore dhe të kërkojnë përgjigje për to. Ata zhvillojnë aftësi për të planifikuar hapat e kërkimit dhe për të përcaktuar burimet dhe mënyrat për mbledhjen e informacionit. Pjesë e procesit të kërkimit është zgjidhja e problemeve, përballimi i sfidave dhe kapërcimi i pengesave. Pra nxënësit ndihmohen të zhvillojnë aftësi për të eksploruar dhe për të hetuar për një çështje, problem apo pyetje hipotetike.

**Hulumtimi** është procesi i mbledhjes së informacioneve të vlefshme për një temë/ pyetje kërkimore të caktuar. Vlerësimi i aftësive kërkimore/hulumtuese tek nxënësit gjatë zhvillimit të një projekti kërkon qasje të ndjeshme dhe të përshtatur me moshën dhe zhvillimin e tyre. Aftësitë kërkimore të nxënësit të arsimit fillor shfaqen nëpërmjet kërkimit nëpër libra, enciklopedi, biblioteka, intervista, eksplorime të mjedisit, përvojave praktike dhe përpjekjeve për të zgjidhur probleme të thjeshta. nëpërmjet këtyre burimeve nxënësit mbledhin informacione, duke i dalluar sipas rëndësisë dhe fillojnë të besojnë në burime të caktuara. Gjithashtu, nxënësit zhvillojnë mendimin kritik dhe mësojnë të zgjedhin të dhënat, t'i analizojnë dhe t'i vlerësojnë. Gjatë zhvillimit të projekteve, këto aftësi mund të vëzhgohen dhe të vlerësohen vazhdimisht për të siguruar që nxënësit po përfitojnë nga zhvillimi i projektit.

**Kreativiteti** është i lidhur me aftësitë krijuese të nxënësit, me zhvillimin e imagjinatës dhe gjetjen e mënyrave kreative të shprehjes së ideve dhe të mendimeve. Pjesë e aftësive krijuese është gjetja e zgjidhjeve të reja, origjinaliteti i tyre dhe "prodhimi" i ideve/zgjidhjeve inovative, duke i bërë projektet unike. Paraqitja vizuale dhe artistike luan rol të rëndësishëm në organizmin dhe prezantimin në mënyrë krijuese dhe të këndshme të projektit.

### B. Treguesi i cilësisë: Analiza dhe interpretimi i të dhënave duke përdorur teknika të përshtatshme

Gjatë realizimit të projektit, nxënësit zhvillojnë aftësitë e **analizës dhe të interpretimit të të dhënave**. Vëzhgimi dhe vlerësimi i këtyre aftësive bëhet duke marrë parasysh moshën dhe zhvillimin e tyre kognitiv. Mbledhja e të dhënave mund të bëhet nëpërmjet anketave dhe pyetësorëve të ndryshëm. Gjatë përpunimit të të dhënave, nxënësit mësojnë të dallojnë burimet që u japin informacion të besueshëm, mësojnë si t'i kategorizojnë të dhënat, bëjnë analiza të thjeshta statistikore, me të dhënat numerike. Ata mësojnë si t'i strukturojnë gjetjet e tyre me ndihmën e grafikëve, të tabelave etj. Interpretimi i gjetjeve, krijimi i lidhjeve ndërmjet të dhënave dhe nxjerrja e përfundimeve logjike e të arsyetuara janë aftësi të rëndësishme që nxënësit i zhvillojnë gjatë projektit, në fazën e përpunimit të informacionit dhe të të dhënave të grumbulluara. Nxënësit mësojnë të organizojnë informacionin e grumbulluar në mënyrë logjike, të kuptueshme dhe sipas një rendi, paraprirë nga rezultatet e projektit.

Në këtë fazë të projektit, nxënësit mësojnë, gjithashtu, të krahasojnë të dhënat nga burime të ndryshme, të evidentojnë ngjashmëri dhe ndryshime dhe të bëjnë pyetje të reja që lidhen me temën.

### C. Treguesi i cilësisë: Aftësitë e prezantimit të rezultateve të projektit

Vëzhgimi dhe vlerësimi i aftësive të prezantimit të rezultateve dhe produktit nga ana e nxënësve është një proces që ndihmon në zhvillimin e aftësive të komunikimit, të vetëbesimit dhe të shprehjes së ideve në mënyrë të qartë dhe të strukturuar. Në këtë fazë nxënësit demonstrojnë aftësitë e komunikimit verbal, nëpërmjet artikulimit të mendimeve, përdorimit të tonit të zërit dhe gjuhës së trupit. Gjithashtu, nxënësit zhvillojnë aftësitë për të menaxhuar pyetje, për të mirëpritur kritika dhe sugjerime nga audienca.

| Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular për kategorinë “Mësues specialist” Gjithsej 40 pikë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Përshkruesi** | **Niveli 1** (Dobët) | **Niveli 2** (Mjaftueshëm) | **Niveli 3** (Mirë) | **Niveli 4** (Shumë mirë) |
| **Demonstrimi nga nxënësit i aftësive hulumtuese, kërkimore, krijuese (12 pikë)** | | | | |
| | 0 pikë | 1 pikë | 2 pikë | 3 pikë |
| **Demonstrim nga nxënësit i aftësive hulumtuese, kërkimore dhe krijuese (3 pikë)** | • Nxënësit nuk shfaqin interes për të eksploruar mjedisin që i rrethon;<br>• Nxënësit nuk përpiqen për të menduar dhe bërë pyetje problemore;<br>• Mjedisi i klasës është i varfër me materiale dhe burime që nxisin nxënësit të eksplorojnë apo të bëjnë pyetje për hulumtime. | • Nxënësit shfaqin interes dhe përpiqen të bëjnë pyetje, të eksplorojnë, por burimet janë relativisht të varfra;<br>• nxënësit tërhiqen para sfidave dhe nuk u japin dot zgjidhje situatave në të cilat ndodhen;<br>• nxënësit përpiqen, por paraqesin vështirësi për të arritur rezultate.<br>• Mësuesi i ndihmon nxënësit të zhvillojnë disa | Nxënësit:<br>• shfaqin kuriozitet dhe bëjnë pyetje të rëndësishme gjatë eksplorimit të materialeve dhe burimeve;<br>• kanë mbledhur prova gjatë eksplorimeve të ndryshme;<br>• janë përpjekur për të zgjidhur probleme të thjeshta<br>• kërkojnë ndihmën e mësuesit për të shprehur idetë e tyre; | Nxënësit:<br>• marrin pjesë në aktivitete hulumtuese;<br>• shfaqin kuriozitet dhe bëjnë pyetje të rëndësishme;<br>• përdorin mënyra të ndryshme të përdorimit të materialeve;<br>• përdorin gjuhë dhe mënyra të ndryshme për të shprehur idetë e tyre;<br>• punojnë së bashku për të hulumtuar rreth një teme, duke |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | aftësi kërkimore përmes bashkëveprimit me njëri-tjetrin. | • në pjesën më të madhe të veprimtarive kanë punuar së bashku dhe kanë ndarë idetë dhe mendimet me njëri-tjetrin.<br><br>Mësuesi<br><br>• nxit nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike dhe duke i inkurajuar të eksplorojnë mundësi të ndryshme;<br>• nxit kuriozitetin dhe dëshirën e nxënësve për të mësuar;<br>• nxit nxënësit të përdorin imagjinatën e tyre dhe të jenë krijues në zgjidhjen e | ndihmuar dhe ndarë idetë dhe mendimet me njëri-tjetrin.<br><br>Mësuesi<br><br>• nxit nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike, duke i pyetur për arsyetimet dhe duke i inkurajuar të eksplorojnë mundësi të ndryshme;<br>• nxit kuriozitetin dhe dëshirën e nxënësve për të mësuar;<br>• nxit nxënësit të përdorin imagjinatën e tyre dhe të jenë krijues në zgjidhjen e problemeve dhe realizimin e projektit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | problemeve dhe realizimin e projektit. | |
| **Bashkëpunimi në grup (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | Nxënësit:<br>• nuk aktivizohen në diskutime dhe aktivitete grupi;<br>• paraqesin vështirësi në bashkëpunim me njëri-tjetrin.<br><br>Mësuesi:<br><br>• nuk organizon veprimtari që nxënësit të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. | Nxënësit:<br>• aktivizohen në diskutime dhe në aktivitete grupi kur ua kërkon mësuesi;<br>• marrin pjesë më shumë në veprimtari individuale;<br>• nuk marrin iniciativa për punë të përbashkëta.<br><br>Mësuesi:<br><br>• inkurajon nxënësit të punojnë së bashku, por nuk arrin rezultate konkrete;<br>• nxënësit ndajnë idetë me njëri-tjetrin në mënyrë sporadike. | Nxënësit:<br><br>• përfshihen në diskutime dhe aktivitete grupi;<br>• krijojnë produkte të përbashkëta;<br>• përpiqen së bashku për t'i dhënë zgjidhje 'problemeve' që u dalin;<br>• u përgjigjen pyetjeve që u bëhen për produktet e përbashkëta;<br>• ndihmojnë njëri-tjetrin në përfundimin e aktiviteteve.<br><br>Mësuesi:<br><br>• inkurajon nxënësit të | Nxënësit:<br><br>• marrin pjesë aktive në diskutime dhe aktivitete grupi;<br>• krijojnë produkte të përbashkëta;<br>• japin kontribute në diskutime;<br>• punojnë së bashku, ndajnë mendime dhe koordinojnë aktivitetet e tyre;<br>• mësojnë të punojnë së bashku dhe të respektojnë mendimet e njëri-tjetrit;<br>• tregojnë empati për ndjenjat dhe idetë e bashkëmoshatarëve; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | punojnë së bashku;<br>• ndihmon nxënësit të punojnë në grup;<br>• inkurajon nxënësit të shprehin mendimet e tyre, të dëgjojnë të tjerët dhe të komunikojnë në mënyrë efektive. | • menaxhojnë situata tensioni ose konflikti;<br>• arrijnë rezultate në punën që kryejnë.<br><br>Mësuesi:<br><br>• nxit nxënësit për të marrë iniciativa për të udhëhequr grupin;<br>• Inkurajon nxënësit të punojnë së bashku për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe të bashkëpunimit;<br>• luan rolin e ndërmjetësit për të ndihmuar nxënësit të punojnë në grup, duke i mësuar ata të ndajnë detyrat dhe të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | bashkëpunojnë me njëri-tjetrin;<br>• ndihmon në ndërtimin e aftësive për bashkëpunim dhe ndarje të ideve, duke nxitur ndërveprimin social;<br>• inkurajon nxënësit të shprehin mendimet e tyre, të dëgjojnë të tjerët dhe të komunikojnë në mënyrë efektive përmes bisedave të strukturuara dhe të hapura. |
| **Përqendrimi i nxënësve te aktivitetet dhe detyrat (3 pikë)** | 0 pikë | 1 pikë | 2 pikë | 3 pikë |
| | Nxënësit:<br>• janë të shpërqendruar;<br>• nuk e ruajnë fokusin te detyra që po punojnë;<br>• Mësuesi nuk i ka nën | Nxënësit:<br>• ruajnë fokusin te detyra që po punojnë dhe ndajnë idetë me njëri-tjetrin;<br>• ndjekin radhën e veprimeve. | Nxënësit:<br>• janë të fokusuar në detyrat e përbashkëta;<br>• bisedojnë dhe ndajnë idetë me njëri-tjetrin; | Nxënësit:<br>• ndihen më të angazhuar dhe të përgjegjshëm për procesin e të mësuarit;<br>• janë të fokusuar në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | kontroll veprimet e nxënësve. | Mësuesi:<br><br>• ndihmon nxënësit duke treguar se si t'i përdorin materialet në mënyrë të sigurt dhe të saktë;<br>• lavdëron nxënësit që përfundojnë detyrat në kohë dhe me cilësi;<br>• përpiqet të krijojë një mjedis të qetë që ndikon në përqendrimin e nxënësve. | • përdorin mënyra të ndryshme në përdorimin e materialeve.<br><br>Mësuesi:<br><br>• krijon një atmosferë ku nxënësit kanë mundësi të eksplorojnë;<br>• ndihmon nxënësit duke treguar se si t'i përdorin materialet në mënyrë të sigurt dhe të saktë;<br>• lavdëron nxënësit që përfundojnë detyrat në kohë dhe me cilësi;<br>• krijon një mjedis që ndikon pozitivisht në përqendrimin e nxënësve. | detyrat e përbashkëta;<br>• provojnë gjëra të reja, por të lidhur me detyrën që po kryejnë;<br>• ruajnë fokusin te detyra kur diskutojnë dhe ndajnë idetë me njëri-tjetrin.<br><br>Mësuesi:<br><br>• krijon një atmosferë ku nxënësit ndihen të lirë të eksplorojnë, të bëjnë gabime dhe të mësojnë prej tyre;<br>• ndihmon nxënësit duke treguar se si t'i përdorin materialet në mënyrë të sigurt dhe të saktë;<br>• lavdëron nxënësit që përfundojnë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | detyrat në kohë dhe me cilësi; <br>• krijon një mjedis që ndikon pozitivisht në përqendrimin e nxënësve. |
| **Përshtatshmëria e informacioneve me detyrat (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | • Informacionet e mbledhura nga nxënësit dhe mësuesi janë të pakta; <br>• nxënësit bëjnë përpjekje për t'i lidhur informacionet dhe për të nxjerrë një përfundim; <br>• mësuesi nuk i ndihmon nxënësit të tregojnë çfarë kanë mësuar prej informacioneve të mbledhura. | Nxënësit: <br>• përdorin pak burime për të marrë informacion; <br>• interpretojnë informacione; <br>• paraqesin vështirësi në lidhjen ndërmjet fakteve; <br>• interpretojnë informacionin e mbledhur, por hasin vështirësi për të nxjerrë përfundime të vlefshme; <br>• mësuesi ndalet pak në interpretimin e | Nxënësit: <br>• përdorin burime të ndryshme për të mbledhur informacionin që u duhet për detyrën që po kryejnë; <br>• analizojnë dhe interpretojnë informacionet e mbledhura; <br>• dallojnë se cili informacion është i vlefshëm për detyrën që po kryejnë; <br>• zhvillojnë mendime të reja gjatë | Nxënësit: <br>• përdorin burime të ndryshme si libra, fotografi ose burime digjitale; <br>• analizojnë dhe interpretojnë informacione; <br>• bëjnë lidhje midis fakteve dhe formulojnë mendime të reja; <br>• analizojnë dhe interpretojnë informacionin e mbledhur dhe nxjerrin |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | informacionit dhe në përshtatjen e tij me detyrën. | përpunimit të informacionit.<br><br>Mësuesi:<br><br>• nxit nxënësit të analizojnë se si përshtatet informacioni me detyrën e dhënë. | përfundime të vlefshme;<br>• zhvillojn ë aftësitë e tyre për të mbledhur, përpunuar dhe përdorur informacionin në mënyrë efektive.<br><br>Mësuesi:<br><br>• nxit nxënësit të diskutojnë për informacionin e mbledhur dhe e analizojnë së bashku;<br>• ndihmon nxënësit të përzgjedhin informacionin për detyrën që u duhet;<br>• siguron materiale që nxisin kreativitetin e nxënësve;<br>• koordino n aktivitete të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ndryshme, për të cilat nxënësit përdorin burime efektive. |
| **ANALIZA DHE INTERPRETIMI I TË DHËNAVE DUKE PËRDORUR TEKNIKA TË PËRSHTATSHME (10 PIKË)** | | | | |
| **Përdorimi i teknikave të përshtatshme, efektive, krijuese, origjinale 3 pikë** | 0 pikë | 1 pikë | 2 pikë | 3 pikë |
| | • Gjatë realizimit të projektit, nxënësit nuk kanë përdorur teknika të përshtatshme për analizën dhe interpretimin e të dhënave;<br>• nxënësit nuk kanë bërë krahasime, grupime, klasifikime duke përdorur ngjyra në përpunimin e të dhënave.<br>• mësuesi nuk zotëron njohuri për përdorimin e teknikave të përshtatshme për të organizuar dhe | Nxënësit:<br>• kanë përdorur të njëjtat teknika për të bërë interpretime të të dhënave gjatë gjithë projektit;<br>• paraqesin vështirësi në analizën dhe interpretimin e të dhënave.<br><br>Mësuesi:<br>• kërkon nga nxënësit të bëjnë analiza dhe të nxjerrin përfundime nga të dhënat e grumbulluara.<br>• nuk përfshin në | Nxënësit:<br>• nëpërmjet shembujve konkretë analizojnë të dhënat;<br>• gjatë projektit kanë krijuar diagrame, tabela, që i i ndihmojnë të bëjnë interpretime;<br>• me ndihmën e mësuesit, mbledhin, përpunojnë dhe analizojnë të dhënat;<br><br>Mësuesi: | Nxënësit:<br>• kanë përdorur teknika të ndryshme, si vëzhgime, vizatime, grupime, klasifikime për të bërë analizën dhe interpretimin e të dhënave;<br>• nëpërmjet shembujve të thjeshtë e konkretë nxënësit analizojnë të dhëna dhe krijojnë diagrame, tabela, vizatime dhe ilustrime;<br>• ndajnë përvojat dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | analizuar të dhënat;<br>• mësuesi nuk i nxit nxënësit të bëjnë interpretime të të dhënave, të rezultateve dhe të përfundimeve që kanë nxjerrë nxënësit gjatë projektit. | interpretimin e të dhënave të gjithë nxënësit;<br>• përpiqet t'i nxisë nxënësit nëpërmjet pyetjeve të bëjnë analiza dhe interpretime. | • ndihmon fëmijët në analizën dhe interpretimin e të dhënave;<br>• i nxit nxënësit nëpërmjet pyetjeve dhe 'sfidave' për të bërë analiza e interpretime të reja.<br>• përpiqet që çdo fëmijë të bëjë analiza e interpretime të thjeshta;<br>• siguron mjete dhe materiale që nxënësit t'i mbledhin e t'i analizojnë të dhënat në mënyrë praktike. | mendimet për rezultatet e arritura në grup;<br>• zhvillojn ë aftësitë e tyre për të mbledhur, përpunuar dhe përdorur informacionin në mënyrë efektive;<br>• reflektoj në mbi procesin e kryer dhe diskutojnë për teknikat e përdorura.<br><br>Mësuesi:<br><br>• zhvillon aftësitë e mendimit kritik dhe analitik të nxënësve në analizën dhe interpretimin e të dhënave;<br>• vlerëson punën dhe përpjekjet e nxënësve duke rritur interesin e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | tyre për analiza dhe interpretime të dhënash;<br>• i nxit nxënësit nëpërmjet pyetjeve dhe 'sfidave' për të bërë analiza e interpretime të reja;<br>• mbështet nxënësit që paraqesin vështirësi në analizën dhe interpretimin të dhënave;<br>• siguron mjete dhe materiale që nxënësit, t'i mbledhin dhe t'i analizojnë të dhënat në mënyrë praktike. |
| **Analiza, interpretimi dhe zgjidhja e problemeve**<br>**3 pikë** | 0 pikë | 1 pikë | 2 pikë | 3 pikë |
| | • Nxënësit nuk demonstrojnë aftësi të analizës dhe interpretimit | Nxënësit:<br>• shfaq si aftësi të analizës së të dhënave, | Nxënësit:<br>• shfaqin aftësi të analizës dhe | Nxënësit:<br>• identifikojnë dhe analizojnë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | të të dhënave, fakteve dhe ngjarjeve;<br>• nxënësit nuk bëjnë lidhje logjike të të dhënave;<br>• mësuesi nuk kërkon nga nxënësit të interpretojnë, të sjellin përvoja të ngjashme, të kuptojnë lidhjet shkak-pasojë të ngjarjeve, të bëjnë krahasime dhe klasifikime të thjeshta. | por nuk bëjnë interpretime të tyre;<br>• paraqesin vështirësi në krijimin e lidhjeve logjike mes ngjarjeve;<br>• shfaqin mendime për ngjarjet që përjetojnë vetëm nëse pyeten;<br>• bëjnë krahasime mes 2 objekteve konkretë;<br>• paraqesin vështirësi në analizat shkak-pasojë;<br>• hasin vështirësi për të gjetur zgjidhje në problemet që hasin.<br><br>Mësuesi:<br>• nuk i motivon nxënësit të bëjnë krahasime, | interpretimit të të dhënave, fakteve dhe ngjarjeve;<br>• bëjnë lidhje logjike dhe shprehin mendimet e tyre mbi ato që shohin dhe përjetojnë;<br>• bëjnë krahasime mes objekteve, ngjarjeve dhe dukurive të thjeshta;<br>• bëjnë lidhje të thjeshta shkak-pasojë;<br>• përpiqen të gjejnë zgjidhje në problemet që hasin.<br><br>Mësuesi:<br>• i nxit nxënësit të bëjnë lidhje të ngjarjeve me përvoja personale; | elementët kyç të informacionit të mbledhur për projektin;<br>• formulojnë hipoteza të arsyeshme mbi informacionin që analizojnë;<br>• diskutojnë dhe ndajnë ide për të gjetur zgjidhje;<br>• komunikojnë idetë dhe informacionet në një mënyrë të kuptueshme;<br>• ofrojnë zgjidhje për problemet e hasura gjatë zhvillimit të projektit;<br>• ndihmojnë njëri-tjetrin në interpretimin e të dhënave.<br><br>Mësuesi:<br>• luan rolin e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | analiza shkak-pasojë, arsyetime logjike rreth informacioneve, objekteve, ngjarjeve të thjeshta;<br>• kërkon nga nxënësit të bëjnë interpretime, por nuk bën përmbledhjen dhe vijimin e shfaqjes së mendimeve të reja të nxënësve. | • kërkon nga nxënësit të bëjnë analiza dhe interpretime bazuar në mendimet e tyre. | lehtësuesit duke u ofruar nxënësve ndihmë të kujdesshme për të zgjidhur problemet dhe mundësi të mendojnë për zgjidhje në mënyrë të pavarur;<br>• ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike dhe interpretuese;<br>• justifikon zgjidhjet e nxënësve dhe jep arsye për vlefshmërinë e tyre;<br>• analizon se si grupi i nxënësve e përballon zgjidhjen e problemeve. |

| **Përdorimi i skemave dhe diagrameve të ndryshme (4 pikë)** | 0-1 pikë | 2 pikë | 3 pikë | 4 pikë |
|---|---|---|---|---|
| | • Nxënësit nuk kanë përdorur skema dhe diagrame të thjeshta gjatë zhvillimit dhe prezantimit të projektit ;<br>• Nxënësit nuk e kanë të organizuar paraqitjen vizuale të projektit;<br>• nuk kanë krijimtari dhe origjinalitet në punimet e krijuara;<br>• Mësuesi nuk është kujdesur për t'i ndihmuar nxënësit t'i organizojnë materialet në skema e diagrame, për të qenë më i kuptueshëm informacioni i paraqitur. | Nxënësit:<br>• kanë përdorur vizatime për të ilustruar ide dhe koncepte, por paraqesin vështirësi të tregojnë pse i kanë zgjedhur;<br>• punimet janë të varfra me mënyra krijuese dhe origjinale;<br>• paraqesin vështirësi në krijimin e skemave dhe të diagrameve.<br><br>Mësuesi:<br>• nuk i nxit nxënësit të përdorin materiale të larmishme vizuale;<br>• nuk i ndihmon nxënësit të | Nxënësit:<br>• kanë përdorur simbole të thjeshta për të shfaqur ide;<br>• kanë paraqitur ide në mënyra krijuese;<br>• kanë punuar së bashku për të krijuar skema dhe diagrame të thjeshta;<br>• në produktin final kanë përfshirë skema dhe diagrame të thjeshta.<br><br>Mësuesi:<br>• i ka nxitur nxënësit të përdorin materiale vizuale si figura, piktura ose | Nxënësit:<br>• kanë përdorur simbole dhe forma për të ilustruar ide dhe koncepte dhe tregojnë edhe pse i kanë zgjedhur;<br>• përdorin kanë përdorur ngjyrat dhe format për të theksuar elementë të rëndësishëm;<br>• kanë paraqitur idetë dhe rezultatet e tyre në një mënyrë krijuese;<br>• kanë punuar së bashku për të krijuar skema dhe diagrame;<br>• kanë krijuar një produkt final që |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | krijojnë skema të thjeshta në organizimin e figurave dhe të vizatimeve. | grafikë të thjeshtë;<br>• ka ndihmuar nxënësit të organizojnë informacionin në diagrame dhe skema të thjeshta. | përfshin skema dhe diagrame.<br><br>Mësuesi:<br><br>• ka nxitur nxënësit të përdorin materiale vizuale si figura, piktura ose grafikë për të mbështetur informacionin që paraqesin;<br>• ka ndihmuar nxënësit të organizojnë informacionin në mënyrë logjike përmes diagrameve<br>• është kujdesur që idetë e të gjithë nxënësve të jenë prezantuar nëpër skema e diagrame. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| **Aftësitë e prezantimit të projektit (18 pikë)** | | | | |
| **Organizimi i materialeve dhe qartësia në të kuptuarit e tij (6 pikë)** | 0-1 pikë | 2-3 pikë | 4-5 pikë | 6 pikë |
